**Një grua e dobët (e hollë) 42 vjeçe e tipit leptozmen ("asht e lëkurë" vuan nga migrena parasëgjithash gjatë ditëve sa i ka periodat dhe dhimbjeve në regjionin e zverkut. Në këto ditë ajo nuk është fare në vete, shtypja e gjakut i zbret nën 100 dhe i hum pothuajse tërësisht oregksi. Kontrolli i shpinës rezulton me të dhënat se ka të bëjë me qarkullim të dobët të gjakut në zonat reflektive në regjionin e segmenteve të lukthit, në segmentet e mëlçisë dhe segmenteve gjenitale. Përmes aplikimit të terapisë me përthithje të thatë dhe masazhës përthithëse të majave në vendet e përshkruara sëmundja pati mundësi të mënjanohet.**

**Shembull: Përthithja e thatë tek Ileusi**

**Një djalosh 24 vjeçar vuan që nga mosha e djalërisë së hershme nga Megakolona. Për shkak të paraqitjes së herë pas herëshme të Subileusit dhe Ileusit i duhej t' i nënshtrohej operacionit disa herë, derisa në fund pothuajse iu largua e tërë zorra e trashë. I tërë barku i ishte shndrruar në blanë. Sërish, pak pas operacionit, vije deri te paraqitja e Subileusit dhe Ileusit, që e bëjnë të domosdoshëm edhe një trajtim stacionar. Kontrolli i tërësishëm nxit gjakderdhje të brendshme në tërësi, gjendje spastike në kuptimin e blanave të ftohta dhe daljeve në shpinë. Pasi që pacienti i nenshtrohet trajtimit përmes përthithjes së thatë dhe masazhës përthithje të majave, rastet e paraqitjes së Subileusit dhe Ileusit u rralluan ndjeshëm, duke u paraqitur vetëm një herë në çdo katër muaj.**

## 2. 6 Përmbledhje

**Një mjek, që është ambientuar me aplikimin e përthithjes si terapi shëruese, nuk do të denjojë më të praktikojë metodë tjetër bazë.**
**Ajo i duket si terapia ideale , ngase pa atë nuk do të ishte i mundur as parafytyrimi i ndikimit afatgjatë në zonat reflektive. Sipas të gjitha prezentimeve të deritashme, zonat reflektive duhet të trajtohen përherë, nëse duam që ta risjellim kibernetikën sërish në trup. Kjo rrjedh sipas një skeme tashmë të cituar, kështu:**

**Lëvizjet e trajtave ↔ Procese bioelektrokimike ↔ Procese fizikale ↔ Procese shpirtërore ↔ Fuqi mendore**

**Ngjitja në kybernetikën e organizmit është i mundur nga shumë nivele.**
**Kë¨te na dëshmojnë sukseset e shumta, që kanë pasur mjekë të ndryshëm, si neuroterapeutët, homopatët, terapeutët ozonal, psikoterapeutët dhe të ashtuquajturit shërues të shpirtit. Në praktikë është treguar metoda më e lehtë për shërbim përthithja nga një maje në tjetrën si çelës i suksesit.**

**Mjekësia e sotme perendimore e përjashton kybernetikën fare. Ajo është një mjekësi e toplogjisë. Kjo do të duhej të shpjegohej përmes një shembulli.**

**Me kalimin e viteve ajo – mjekësia perendimore, tek njeri i sëmurë mund vetëm të ripërsërisë veten. Nuk do të ishte diçka i zakonshëm prezentimi i mëposhtëm: Një grua që ka mbushur tashti 55 vjet vuan nga obstipacioni dhe nga gurët në mëlçi. Kur është martuar tek ajo është shfaqur me forcën e saj migrena, që largohet gjatë shtatëzanisë. Pas lidhjes së poshtme ("sterilizimit"), i krijohen në vëllim të gjerë fije spazmatike, që shkaktuan tromboflebidet recidive, me çka sidomos vërehej se printe këmba e majtë. Gjatë shumë vitesh ajo ankohej se kishte dhimbje në që të dy nyjet e kokërdhokëve dhe parasëgjithash nga dhimbjet e shpinës në mes shpatullave. Që kur i kanë**

**pushuar periodat asaj i vinë herë-herë valë nxehtësie dhe deri tek pruritusi në regjionin e vaginës. Gjatë analizave është konstatuar se ajo vuan nga granuloma e dhëmbëve e shfaqur në dhëmbin e këndit të anës së djathtë; përmes fotografisë së rentgenit është hetuar mbulesa, respektivisht zënja e që të dy nofullave; përpos kësaj tek ajo është konstatuar edhe depresion i theksuar neuror për shkak të pagjumësisë.**

**Një sëmundje e tillë trajtohet nga ana e: stomatologut, në vend se ta heq dhëmbin fare, ai shkon dhe e përpunon si një shtatore të farë heroi; nga ortopedi, që provon dhimbjet e kërdhokullit (ijet) dhe unazave kurrizore përmes metodäve të tij t'ia largojë, çka shpesh ia arrinë vetëm përmes përdorimit të kimikateve, barnave të llojllojshme; gjinekolohu, që trajton pruritusin dhe valët e nxehta; mjeku i lëkurës, që angazhohet edhe ai për trajtimin e pruritusit dhe më pas duhet t'i trajtojë venat; internisti, që shpjegon gjendjen në reghinin e vrerit dhe zorrë përmes fotografimit rentgenologjik; mjekut të shtëpisë, që lufton kundër migrenës me barëra të shumëta; neurologu, që provon të gjejë dhe t' i luftojë shkaktarët e pagjumësisë dhe depresionit dhe në fund vije kirurgu që largon me ndërhyrje kirugjikale gurët gëlqeror, respektivisht vrerin. Megjithë përpjekjet e gjithëanëshme të një lagjeje topologësh, pacienti sërish nuk është i shëndoshë, përkundrazi ajo vazhdon të vuaj nga shtimi i ndjeshëm i ngacmuesve të sistemit nervor vegjetativ, por më se e qartë, ajo vuan dhe në fund i ipet udhëzimi që të vete tek psikiatri.**
**Mjeku aplikativ – kështu edhe mjeku që aplikon përthithjen si metodë shërimi, e sheh këtë sëmundje si rezultat i pengesave dinamike, që luajnë në të vetmin sistem rregullativ. Në këtë rast kemi të bëjmë me sistemin rregullativ Vrerë/Mëlçi. Trupi përgjigjet në vende të ndryshme të këti sistemi rregullativ shmangja e të cilit tashmë është shkaktuar në pjesë të ndryshme të trupit. Mundësitë janë që, vrimat e nofullave dhe dhëmbi i këndit kanë shaktuar farë ndezje, që kombliku (legeni) i vogël vuan nga farë pengesash të qarkullimit të gjakut dhe parasëgjithash në këmbën e majtë paraqiten variksi e kështu me radhë.**

**Mjeku aplikativ  trajton kështu triger-pointsin të sistemit rregullativ të dëmtuar, të cilin e çëmton dhe e tërë symptomatika e polymorbidetit vete mbrapa deri tek ankesat, të cilat kanë të bëjnë me blana të mbetura (psh. nga artroza e ijeve dhe gurët e mëlçisë).  Mirëpo ndodhë  që blanat shpesh kompenzohen fare pa u vërejtur, nëse gjendja e energjisë është e lartë dhe e baancuar: ndonjë rast për shkak të plasticitetit  të indeve të trupit të shëndoshë lehtë edhe shtangohet.**

**Nëse duam që zonave të përthithjes duam t' ua masim domethënjen dinamike, atëherë mund të konkludojmë sa vijon: Ajo paraqet pamjen ekuivalente të** *një ngjrjejeje që është e dukshme dhe e prekshme  më shenjuese  nga pararendësja, që luan në organizëm dhe atë në somë und saemë. Ajo naparaqitet përmes uljes së saj  deh lidhjet e ndryshme që kjo ngjarje rrjedh në trup ,por jo në rrugë lineare-kauzale, por e gërshetuar.*
*Ajo vet paraqet një ngjitje themelore në sistemit autorregullativ të trupit. Nëse ajo nuk trajtohet , atëherë trupi mbetet në zonat refleksive e bllokuar dhe ushtron terapi symtomatike.*

*Që prej shumë vitesh tashmë ngadalë jemi mësuar që, një ose dy, rrugë reaktive të njohura nga hulumtimet, të paraqitet në trup dhe ndaj tyre  menjëherë edhe të ndërhyhet. Në to kemi njohur rrjedhën e reagimeve lineare. Që nga kjo kohë ne ndërlidhemi në rrugë lineare nga proceset e sëmundjes  kudo në trup.  Në fakt përshkimi i saj ka një pamje rrjete, pra është i ndërlidhur.  Në të vërtetë ajo (sëmundja) është e ndërvarur nga faktorë të ndryshëm. Kështu kemi të bëjmë me gërshetim fenomenesh në një.  Jo vetëm që çdo pjesë e trupit do të informohet nga tjetra, por secila pjesë ragon njëkohësisht me tjetrën.  Se pse vëzhguesi vjen në përfundimin se në pjesë të veçanta të trupit shenjon symptome të ndryshme, kjo varet nga ajo se, sa mënyrat e reagimit –sipas principit relativ  nga vendi dhe koha – duken edhe ndryshe. Përvoja në jetë rrjedhë në rregullin e madh atomizues dhe ose molekular. Fizika atomike moderne na ka mundësuar që të shfrytëzojmë principin e relativitetit të Ajnshtajnit. Edhe në nivelin molekular kemi të bëjmë gjithashtu me procese që janë*

*përherë në kundërvënje të njëri-tjetrit. Atomet dhe elektronet vallëzojnë në lëvizjen e kontrolluar të kolizionit dhe rotacionit, ku arrihet shpejtësia Mah 2 dhe teperaturat më të larta prej 400°C. Në kuptimin më esencial drejtohet e tëra përmes një hulumtimi njerëzor dhe një plani të ndërtimit shpirtëror të pakalueshëm dhe impuls jetësor. Të shikojmë të ndërhyjmë me masa njerëzore, atëherë i shkatrrojmë ose gjymtojmë njëkohësisht tjera nivele të rregullativës automatike dhe kështu, ngajnë që, ne punojmë mbi mundësitë e mekanizmit rregullativ që disponon trupi (pikat triger) ose ne i shërbejmë vet materieve të trupit (gjakut, limpfës).*

*Për habi pikëpamjet moderne mbulohen disi me dëshmitë e mjekëve të vjetër, të cilat janë gjetur në rrugë fare intuitive. Edhe atëherë të gjitha paraqitjet tek njeriu në procesin e ndrrimeve zhvillimore janë shikuar të ndërlidhura me njëra-tjerën. Kështu të gjitha tok, bashk me përvojën e brezave, janë ndërlidhur me kozmosin si tërësi. Fizikanti Fritjof Capra (Fritjoff Capra) në librin e tij “The Tao of physics” i ka përdorë si mbulesë që të dy këto njohuri paraprake.*

*Ka shumë vjetë që mjekësia në dëshmitë e saj konstruktiveka përafruar ngase përmes masave paraprake ka shmangur paraliza dhe katastrofa tjera të ndjeshme. Mirëpo vetëm 25% të të gjitha sëmundjeve janë sëmundje që shkaktojnë katastrofa dhe kërkojnë masa që i dedikohen mjekësisë preventive për raste katastrofash, ngase përes vetrrugullativës nuk janë të kontrollueshme, nuk nënshtrohen. Ata që sot ushtrojnë profesionin e mjekut, nuk guxon të mbetet ne kohën e errësirës dhe zymtësisë, në të cilën filozofia mbi ndërlidhjen e sistemit botërorë (rrjetën ku është instaluar), ka përjashtuar. Kush ushtron mjekësinë pa prapavijën filozofike , i përngjet një timonieri që, gjatë shtrëngatës dhe qiellit të mbuluar kërkon qëllimin e tij.*

# *3 Praktika e ztrajtimit të metodës së përthithjes*

## *3.1 Veglat*

- ***Përthithësi ngulçues***

*Tek përthithja e gjakosur arteriet e lëkurës dhe ato të nënlëkurës së pari do të fërkohen (skarifikohen). Me këtë rast hynë në veprim instrumenti shumë i lashtë, i cili me një të rënë prodhon shumë pjesë dhe pacientit ia kursen me një të rënë shumë shpime të panevojshme. Instrumentet mekanike deri tashti më të mirat, të emruara si përthithës ngulçues, i prodhon firma Kirchner & Ëilhelm, Eberhardstrasse 56, 71679 Asperg/Ëürttemberg. Këta përthithës janë plotësisht të sterilizueshëm dhe posedojnë thikëza të ndryshme,që mund të ndërrohen, por edhe shumë kualitative. Me ndihmën e një mekanizmi rrotullues mundet që pjesën ta përcaktojë për veprim të thellë. Ana e dobët edhe e këti konstruksioni është pikërisht në faktin që susta lëvizëse me kalimin e kohës mund të dobësohet dhe kështu thikëzat nuk janë më në gjendje të japin rezultatet e duhura, respektivisht të pritura. Në rast të përdorimit të disaherëshëm të përthitësit ngulçues në po të njejtin vend ku kryeni përthithjen aty mbesin disa pjesë, respektivisht blana lëkure. Këtë rrethanë mund ta tejkalojmë, në rast se përdorim thikëza-kartelë - (Hämolanzette).*

- **Thikëza-kartelë**

*Thikëzat – kartelë janë të përdorshme njëherë dhe janë të paketuara në mënyrë sterile. Me to, gjithësesi duhet të veprojmë me forcë dhe t^i vëmë në veprim së paku dhjetë herë, kështu që për personin që i nënshtrohet përthithjes të jetë e mjaftueshme, pra t' i shkaktohen skarfikacione të mjaftueshme. Prerja, respektivisht shpimi përmes thikëzave – kartelë, pasonë pa ndonjë dhimbje të madhe, por sidoqoftë dhimbja është më e madhe se sa gjatë aplikimit të metodës së përthithjes. Përvoja na*

*ka mësuar se, veçmas tek gratë dhe vajzat, blanat e përthithura në çfardo rasti do të duhej mënjanuar. Nëse nuk i keni që të dy instrumentet në dorë, mund të përdorni edhe një brisk a zhiletë rroje, të cilën paraprakisht duhet ta kaloni nëpër flakë. Mjekët e vjetë ka mundësi që edhe sot posedojnë mekanizmin mekanik të sterilizimit. Edhe ai është një instrument i përshtatshëm, që do të mundësonte kryerjen e skarfikimit.*

*Është e preferueshme që, në një ambulantë me veprime të shumta në këtë lëme¨(përthithjes), të keni më shumë se 15 përthithës të gatshëm, ngase përmes sterilizimit, përherë 30-50% aty për aty nuk janë të gatshme të përdoren. Gjatë procesit të sterilizimit pjesë të lëvizshme të veglës humbasin aftësinë lëmuese, fërkuese. Prandaj atyre do të duhej "dhënë ujë-lagur" në një enë të mbushur me vaj silikoni. Dollapi i përthithesit gjithashtu ruhet në pozicion sterilizues V-2-A- në një filxhan çeliku me kapak.*

- ***Gotat përthithëse***

*Shumë firma ofrojnë gota përthithëse. Unë personalisht i marr dhe shfrytëzoj gotat e firmës Kirchner&Ëilhelm. Ka forma të ndryshme aplikimi të këtyre gotave. Unë vet i përdori vetëm të ashtuquajturat gota me mure dhe buzë të holla. Ata janë të kapshëm dhe të lehtë dhe gjatë përthithjes mund të përdoren duke qenë në pozicionin ulur. Ka gota të tilla të madhësisë të ndryshme. Do të duhej që përherë t' i keni të gatshme për përdorim pothuajse 20 gota.*

*Përpos këtyre ka edhe gota me mure të trashë, përdorimi i të cilëve duket të jetë më i komplikuar e të cilët do të mund të përdoreshin vetëm kur kemi të bëjmë me pacientë tek të cilët përthithjen e bëjmë duke qenë ata në pozicion të shtrirë. Në rast se me këto gota do ta bënim përthithjen në pozicionin ulur, ata prej vet peshës së tyre mund të bien shpejt në dysheme. Që të dy llojet e gotave, ata të trashit si edhe ata me anësore të holla, janë të përshtatshëm njëkohësisht për masazhë përthithëse.*

*Më në fund ka edhe gota me mure të trashë që, të cilët mund të largohen edhe përmes një mekanizmi pompues. Pëdorimi i tyre është jashtëzakonisht i përshtatshëm. Mekanizmi pompues sipas mendimit tim është i panevojshëm*
*Abb. 13: Përthithësi modern*

*Abb. 14: Kambana të ndryshme përthithëse*

*Abb. 15 Veglat mekanike pompuese me buzë e mure të trasha përthithëse*

*Flakadani dhe nxemësi i vatës*

*Unë ju rekomandoj që largimin e gotave përthithëse ta bëni përmes njüe sasie të ndezuar vateje. Me që në një ambullant (Praxix) ku aplikohet metoda e përthithjes si terapi shpesh duhet të behet përthithja e disa paientëve njëkohësisht, preferohet përdorimi i nje mjeti që bënë flakë per kohë më të gjatë, me qëllim që të bëhet ndezja sa e si duhet e vatës. Vata do të duhej të ishte paraprakisht e përgaditur dhe e vendosur ne një vend të veçantë dhe lehtë e kapshme. Gotat, ndezësi dhe vata i vëmë më së miri në një mbajtëse të ve4antë (tabaka a diçka të ngjashme). Ato tok duhet të ruhen në mënyrë të veçantë.*

*Abb. 16: Edhe kjo është një metodë për largimin e gotave për përthithje.*

*Abb. 17: Metoda më e thjeshtë e përthithjes, është njëkohësisht edhe më e mira.*

## 3.2 Teknika e përthithjes

- *Përthithja e thatë*

**Për kryerjen e përthithjes së thatë pacienti do të këshillohet të shtrihet I shlirë e pa rroba në një shtrat. Përmes një lapsi me**

**ngjyrë ose me diç tjetër terapeuti do të vizatojë vendet që do t' I trajtojë. Ndërkaq ndihmësi apo ndihmësja përmes vatës i bënë një ngjeshje të lehtë në funksion të nxemjes së trupit.**
**Vata pastaj lihet në dysheme duke qenë një cep I saj paksa i lagur dhe ngjitet në një pikë dshemeje. Kjo është me rëndësi , ngase për evakuimin e këmbanave të çelçta vata ndizet dhe shërben mirë. Dhe meqenëse koka e përthithësit në fund të aktit të ndezjes së vatës vihet në lëkurën e pacientit, mundet që një pjesë e vatës së djegur të shkëputet e të bie dhe kështu të shkaktojë farë plage të vogël, nëse paraprakisht vata nuk do të ishte e ngjitur për dyshemeje.**
**Një pjesë e evakuar e kokës së përthithësit përthith vetëm një pjesë të lëkurës dhe të arterieve nën lëkurën e pacientit. Nëse e lëmë kambanën, respektivisht gotën e çelçtë që e përdorimsi përthithës në lëkurë , atëhe¨re ajo do ta kryente një pjesë të procesit të ngjyrosjes së arealit të poshtëm dhe pas një kohe I jep një pamje tjetër. Vije kështu deri te formimi I ekstravazateve. Procesi i përthithjes me kë¨te ka marr fund dhe gotat e çel4ta duhet të largohen.**

**Meqenëse përthithjet e thata përpunojnë në të shumtën e rasteve areale të mëdha, atëherë duhet të lihen pranë njëra-tjetrës disa kambana çelçi. Nëse kambanat rrinë për së tepërmi në lëkurë, atëhere mund të vije deri te paraqitja e limpfave në coronalet stratum, me ç'rast pjesa e epërme e lëkurës mund të qohet ushël, sikur në rstet e djegjes. Ky proces nuk do të ishte gjithësesi i përlqyeshëm. Pjesët ku paraqiten limpfat i pikasim me një faculetë a stofë përtharës dhe më pas e lidhim vendin e lënduar si tërësi.**

**Abb. 18 Përthithja e thatë e zonës së lukthit**

- **Masazha përmes pëthithjes (Masazha përmes kambanave përthithëse)**

**Vendi I përpunuar dhe trajtuar I pacientit do të fërkohet mirë me vaj poashtu të mirë. Nëse dëshirojmë që përmes vajit të kemi edhe efekte plotësuese terapeutike, atëherë atëherë është I këshillueshëm përdorimi I vajit të piperit ose vajë plotësisht I përpunuar. I firmës Ëeber & Ëeber. Si edhe tek përthithja e thatë bëhet vetëm një kikë e përthithjes në lëkurë dhe bartet pastaj në**

**arealin që trajtohet. Në këtë rast veprohet si edhe gjatë kryerjes së masazhës  së enëve të gjakut duke përthithur rajonin kryesor përmes këmbanave (gotave) të çelçta. Edhe me kë¨te rast na krijohen ekstravazate. Sidoqoftë edhe me këtë rast vije deri te krijimi i blanave të vogla nën lëkurë. Ky proces është i dëshirueshëm. Nëse pjesa e përpunuar merr ngjyrë blu të mbyllur ose në të kuqe, atëherë përfundohet procesi I masazhës përthithëse. Masazha përthithëse mund të shkaktojë dhimbje relativisht të forta ngjashëm me masazhën e enëve të gjakut. Unë aplikojë sot gjithnjë e më shumë aparaturat PSM të Zëbelajnit (Zöbelein).**

- **Përthithja e përgjakur**

**Terapeuti kontrollon shpinën e pacientit ashtu si është përshkruar ky akt në kapitullin "Shpina si fushë e punës diagnostifikuese". Gjatë këti kontrolli terapeuti vizaton me lapsin me ngjyrë lëkurën në vendet ku do të kryhet përthithja.Nga ana e terapeutit përmes benzinës së pastër bëhet pastrimi I këtyre vendeve nga yndyra e lëkurës, I bëhet nxemja paraprake dhe si edhe gjatë përthithjes së thatë vendosen kokat përtharëse evakuese. Në këto vende ku kryhet ky akt del paksa gjak në shpërthim, Kjo pjesë pastaj me kujdesin më të madh përpunohet dhe kështu vazhdohet të vendoset ena në vendin tjetër. Kur tërhiqet koka perthithëse do të duhej që buza e enes prej çelçi të mos e prek plagën. Ndrrimi I kokave përthithëse do të përsëritej aq gjatë, derisa në vendet ku kryhet akti I përthithjes të mos dal më gjak. Tek atëherë procesi mund të thuhet se ka përfunduar. Plaga e vogël pastaj trajtohet me ndonjë mjet rrethanor, ose thjesht me farë kremi – nivea është e preferueshme, - dhe mbulohet. Vendi I trajtuar (plaga e mbuluar) mbahet kështu dy ditë. Pastaj përsëri mund të lahet. Përmbajtja e kokës së përthithur (fjala është për majën e lëkurës ku është trajtuar dhe krijuar njefarë e queme e lëkurës-SR) zbrazet në një enë çelçi, ndërkaq gotat e çel4ta që I kemi shfrytëzuar për këte veprim I shpërlajmë fort e mirë, I thajmë, I lëmë në sandëkun përkatës të sterilizuara dhe gjysmë të sterilizuara I ruajmë për përdorim të më vonshëm. Nëse jemi të kujdeshëm gjatë punës, nuk ndodhë**

**kurrë që të krijohet farë kolizioni, dëmtimi I plagëve me çelç. Puna me bartës të virusit hepatitis kërkon kujdesë të veçantë.**

---

**Abb. 19: Përthithja e përgjakure zonës së veshkëve dhe portës së erës tek astma dhe typusi i përmbushur**

**Përthithja e përgjakur mund të bëhet tek pacienti në pozitë të shtrirë. Kjo pozitë është e këshillueshme posaçërisht për personat e ndjeshëm dhe të frikshëm, ose për ata që vuajnë nga çrregullimet e qarkullimit të gjakut. Përndryshe përthithja bëhet në pozicion të ulur. Unë kam përshtypjen se, rrjedha e punës ër personelin është më e lehtësuar. Gjithashtu edhe vendi I përthithjes përthahet më mirë dhe kështu pason një lloj shërimi efektiv. Nëse terapeuti nuk mund të marr vendim, nuk është I sigurtë se a ka nën gishtrinjë blanë të cilën do të duhej trajtuar me përthithje të përgjakur apo përmes asaj të thatë, atëherë ai do të mund t'I ndihmonte vetes edhe me një veprim artistik: e lagë dhe vajosë lëkurën e pacientit me vaj bimësh. Terapeuti merr një monedhë, apo thjesht me buzën e një goteje/çelçi përthithës dhe me forcë vepron (gërryen) mbi vendin e dyshimtë. Nëse pas një veprimi të këtillë në kohë fare të shkurtër vije deri te ndrrimi I ngjyrës, atëherë indikacionet se pacienti ka nevojë për një përthithje të gjakosur janë më se 90% të sigurta. Kjo diagnozë e tipit të këtillë në Kinë trajtohet si masazhë e llojit të vet dhe është e njohur me emrin masazha e monedhës.**
**Abb. 20: Përthithja e gjakosur në zverk**

## 3.3 Vështërsitë gjatë përthithjes

**Gjatë përthithjes së gjakosur mund të vije edhe deri te farë vështërsie. Pacientët labil, sidomos herën e parë, janë kundër provokimit të të dobësuarit të qarkullimit të gjakut. Kjo në të shumtën e rasteve ka arsye thjeshtë psikologjike. Frika dhe mëdyshja shkojnë e treten atëherë kur vërehen ndikimet pozitive të një veprimi të këtillë. Gjatë përthithjes në zonën e zemrës, në pjesën e epërme të supit të majtë, mund të vije deri tek rënja e hypotoneve të mirëfillta, ashtu që pacientit duhet t'i kushtohet kujdesë i veçantë. Gjatë përthithjes shpeshëherë pacientin, në**

**raste të këtilla, duhet pyetur se a e ndjen veten mirë. Fillimi i kolapsit të qarkullimit të gjakut si vështërsi e lloit paraqitet shpejt, në fakt papritmas dhe në rast të këtillë duhet vepruar poashtu shpejt, nëse dëshirohet që pacienti shpejt ta marr veten. Atëherë duhet që karriga apo ulësja tjetër, në të cilin është i ulur pacienti, përherë të jetë pranë një shtrati. Me t' u paraqitur komplikimi i qarkullimit të gjakut, atëherë pacienti grishet me zë të lartë që, t' bie në shtrat, kokën ta mbajë të varur poshtë, dhe tek pastaj ia heq me të shpejt gotën e çelçtë nga blana. Pastaj pacientin e shtrijmë në shtrat. Këmbët e tij, për një kohë tüe shkurtër, i mbahen lartë ose paksa të ngritura në njefarë nënkrese të lënë enkas për këtë çështje aty afër. Me pak pika të medikamentit biologjik për ndihmë në qarkullimin e gjakut, gjendja brenda pak minutash rikthehet në normalitet. Nüe fund pacienti, ashtu në pozicion shtrirë, madje ta vazhdojë dhe përfundojë aktin e përthithjes.**

**Në rastet të veçanta mund të ndodhë që pacienti nuk e merr veten në kohë të duhur. Atëherë në fakt mundet që për kohë fare të shkurtër të bie në alivani (të fikët). Ky akt i ngjet stadiumit të ekscitimit nga veprimi i farë narkozeje. Pacienti pas kësaj kthehet në pozicionin anash, disa herë i sjellim shuplaka në fytyrë dhe e ftojmë me zë të lehtë, derisa ai të përmendet dhe pastaj veprohet si e përshkruam më lartë. Sipas përvojës pacientët i tolerojnë vet këto farë komplikimesh të vogla dhe për ta janë si të paqena dhe e shumta ndonjë prej tyre mund të shprehet "se kjo do të duhej t' ju ndodhte edhe juve".**

**Natyrisht përherë ka raste që përsëriten, ashtu që edhe në rast se zgjidhet vendi fare i këndshëm i përthithjes dhe gjatë skarfikimit të thellë nuk vije fare te përgjakja, ose ndodhë por fare pak. Disa prej terapeutëve në raste të këtilla ju preferojnë pacientëve që para se të vazhdojnë trajtimin (përmes përthithjes) të bëjnë banjë të nxehtë ose pas një saune të lezetshme. Ndërkaq ka terapeutë që para çdo përthithjeje kryejnë një akt të nxitjes (përmes "rrahjes", respektivisht gërvishjeve me pflaster), duke provokuar kështu edhe përskuqjen e kapilarëve. Një kompresë (peshkir) i nxehtë do të kishte ndikim të mirë në raste**

**të këtilla, dhe nëse është kryer akti i skarfikimit dhe megjithatë nuk ka përskuqje, respektivisht gjakdedhje, pra atëherë kur edhe buzët e gotës së çelçtë nuk kryejnë punë. Natyrisht se edhe pas masave të këtilla, përkundër “veprimit të ftohtë”, ndodhë që mos të dalë gjak.**

**Nëse provojmë që, blanat e nxehta t'i përthithim në rrugë të thatë, ashtu mundet që menjëherë ose me latencë, të paraqiten gjendje në përgjithësi të vështira ose të vije madje edhe deri tek shpërthime lokale.**

**Pas pëthithjes dobibrurëse në regjionin e kryqeve ose në atë të pjesës së majtë të supeve, mund të vije te dobësimi i sistemit mbrojtës (imunitetit) dhe dobësimi i qarkullimit të gjakut dhe për disa ditë të ketë pacienti një lloj të hypotonisë. Në raste të këtilla njeriu është i shtrënguar që të përdorë pika për ndikim në normalizimin e qarkullimit të gjakut ose tëpërdorë njëfarë glykosidi tertier, psh. mirotonin.**
**Shpesh mund të vërehet, se tek rastet e përgjakjes së dobët të lëkurës së ngritur nën çelçin përthithës, ndërkaq pjesa tjetër shkon e krijonë hartën e mavijosjes nën lëkurë. Në rastet më të shumëta, kur vërehet ky efekt, mund të thuhet se përthithja është bë¨re jo në vendin e duhur. Nganjëherë, madje veçmas në regjionin e qafës, këtë fenomen mundemi edhe ta shmangim disi, ashtu që marrim një gotë/çelç përthithës dhe me tjetrin bëjmë një diametër. Në rastet kur bëhen pa vend hematomet e mëdha, atëherë përtharja e tyre duhet të bëhet me farë kremi të përshtatshëm dhe kualitativ.**

## 3.3 Masat e përkujdesit

**Nëse shikohet pacienti, që sipas gjasave mund të ketë reagime abile të qarkullimit të gjakut, atëherë e ulim në pozicionin e tërthortë/në krah në një shtrat a fron. Ai lëshon pastaj llërën e poshtme të dorës në shtrat dhe lë kokën t' i varet në duar. Kështu në të shumten e rasteve mund të arrihet që të shmangen hypotonet, respektivisht çrregullimi i tyre.**

**Nëse dëshirojmë që, pavarësisht faktit se pacienti ka mungesë energjish, të kryejmë në një vend përthithjen e gjakosur, atëherë atë duhet bërë vetëm kur pacienti është në pozicion të shtrirë. Krahas masave tjera shëruese, si psh. akupunktura, terapia elektroneurale ose medikacioni shoqërues homeopatik, gjatë procesit të përthithjes veçsa sforcohet. Procesi sidomos në rastet e dhimbjes së kokës (edhe tek rastet e shfaqjes së migrenës), tek shfaqjet e formave të ishiasit dhe hstangimeve të veçanta të barkut ka efekte mbrojtëse.**
**Meqë gjatë aktit të përthithjes mund të krijohen blana (shenja), atëherë duhet që vendi për trajtim të matet në mënyrë ekzakte, të saktë dhe jo të veprohet në mënyrë e rrugë pothuajse të egër, të trajtohet çdo nyje e shpinës. Masa terapeutike, njëra prej tyre, që nxit krijimin e blanave, do të duhej të aplikohet vetëm aty ku në fakt pa atë nuk mund të ecet tutje. Në gjendjen e egzistimit të blanave në trup gjejmë shumë shpesh mundësi ndikimi nga larg (Huneke). Unë gjatë trajtimit të blanave tepër rrallë kam pasur rastin që të shoh shpërfaqje të fokusit të tillë. Natyrisht se do të duhej menduar për atë që herëpasëherë blanat e përthithjes të pengohen përmes impletolit.**
**Nëse tek ndonjë pacient janë trajtuar më parë keloidet, pastaj megjithatë do të vazhdojmë me metodën e përthithjes, mirëpo vendin e përthithur duhet ta trajtojmë menjiherë përmes gjilpërave (injeksioneve) me terapeutikë neural. Herë-herë shfaqen dhimbje të forta në vendin e përthithur menjiherë pas përfundimit të përthithjes. Këto dhimbje megjithatë mund të largohen sakaq përmes pikave të impletolit. Edhe përmes përdorimit të Biolyt-Creme-s ose vajit të ricinit ndikohet tek blanat.**
**Në zonën e veshkëve venerohet jo rrallë, megjithë teknikën e saktë të përgjimit përmes përthithjes së çelçtë, një “e shtypur e rrethore e bardhë” për shpjegon dhe mundëson skarfikimin. Këtu nuk rrjedh fare gjak. Kjo nu do të duhej t’ ju bëjë që ta ndërpreni veprimin, pra përthithjen ose edhe ta përfundoni atë. Një ndrrim i shpeshtë i gotave nxit daljene gjakut.**

**Para çdo fillimi të aktit të përthithjes, duhet ta paralajmroni pacientin për mundësin e shpërthimit, respektivisht derdhjes së një sasie të vogël gjaku. Ashtu si është përshkruar tashmë, në shenjë proteste gjatë punës mund të reagohet përmes një kartele hemolani.**

**Si do të duhej reaguar ndaj një pacienti, i cili për shkak të një sëmundje të rrezikshme tashti është në terapinë e gjakosur (psh marcumari)?**
**Unë kam trajtuar pacientë të këtillë, por asnjëherë nuk më ka rënë rasti që pas kryerjes së aktit të përthithjes të kem parë shpërthim gjaku nga vendi i përthithur. Sidoqoftë venerimi i indikacioneve që mund të ishin paralajmrim i një mundësie të tillë, qoftë edhe nën vlerat e një Quiku prej diku 30%, është shenjë se përthithjen e gajkosur duhet pushuar.**

## 3.4 Topologjia indikative

**Vendet e përthithjes, paraqitja e tyre brenda përbrenda sistemit rregullativ dhe domethënja e tyre (indikacioneve topologjike) gjatë trajtimit të secilit të sëmurë.**

- **Paralajmrim**

**Në fillim të prezentimit të topologjisë indikative do të duhej që edhe njëherë të theksohet se, përthithja shikohet si shkallë e lartë e terapisë dhe dëshmon disa mardhënje me format tjera të trajtimit në zonat reflektive. Këto mund të jenë psh masazha e zonave reflektive të këmbëve, masazha e zonave reflektive të të ashtuquajturit Putkamer ose akupunktura. Një terapeut me përvojë në ndonjërën prej metodave të theksuara do të mund të thosht vetëm si rezultat i të dhënave që merr nga teknika e tij e kontrollimit, se në çfarë sistemi rregullativ gjindet një i sëmurë. Këtë mund ta formulojmë edhe kështu: Shenjat e sëmundjes paraqiten vetëm në atë sistem rregullativ, i cili nuk rri, nuk është në harmoni me sistemet tjerë rregullativ.**

**Sistemi i vjetër i shërimit përmes akupunkturës ka ofruar qe pothuajse mijëra vjetë më parë përvojën se si mund të venerohet polysymtomatika e një njeriu të sëmurë. Venerimi i saktë dhe përqasja e të sëmurit shkaktojnë përherë në rrugë të njejtë rikthimin e trigerpointsit, të cilat që prej majës së kokës e deri tek gishtat e këmbëve , ose shprehur më mirë që prej majave të gishtave (të dorës) deri tek gishtat e këmbëve arrijnë dhe i përgjigjen një lloj zingjiri prej pikash. Edhe pengesat tjera kanë pothuajse zingjirë të tillë reagimi. Ështё në rrjedhën e afërt – të gjithë – madje edhe të ndryshmit – disa symtome të ndjeshmërisë jo të mirë, që kanë si rrjedhojë paraqitjen e zingjirit të pikëve, të rregullojnë sistemin vetanak të veprimit. Çe lësi i saj dhe parasëgjithash angazhimi terapeutik, brenda vet metodës së akupunkturimit, janë dëshmuar si jashtëzakonisht me fat. Gjatë venerimit më të kujdesshëm janë të vlefshëm për të gjitha proceset sheruese natyrore.**

**Nëse në pjesën pasuese kur të flitet mbi indikacionet e përthithjes dhe topologjinë e vendeve të përthithjes, del në pah ndërlidhja e aktit të ërthithjes me akupunkturën, atëherë mundet që si fakt të nënvizojmë se, sistemi i saj është i vlefshëm të shpërndaj informacionin në tërë regjionin rregullativ.**

**Me qëllim që ne të kemi orjentim sa më të shpejtë dhe të sakt, po edhe më elementar lidhur me zonat e shpinës, atëherë do të duhej që të bëjmë prekjen (testimin) e shpinës prej zonave kraniale në drejtim të atyre kaudale. Po i rikthehem edhe njëherë kapitullit: Shpina si fushëveprim dhe tavolinë e diagnostifikimit. Prej andej do të duhej të pasonte përshkrimi topologjik i alarmit dhe pikave rregullative, të cilat, po, njëkohësisht janë edhe pika terapeutike, të bëhen sipas kësaj radhe. Rendi nuk pasqyron kurrsesi përparësinë biologjike të disa pjesëve krahasuar me të tjerat.**

| | |
|---|---|
| **Zona e veshit dhe nofullës, respektivisht fëlqisë** | **Organi-Zona aty pranë** |
| **Supi-mbajtës i ujit (buxheta e ngritur)** | **Buxheta hormonale** |

**Dera e erës**

**Korrespondduesi i mushkrive**

**Nyjet interkostale**

**Zona e pankreasit**

**Lugina e lukthit**

**Zona e veshkëve-nyja**

**Pika e hiypertonit**
**Zona depresive**

**Opstipacioni**

**Kocka e grykës**

**Trekëndshi i tonzilies**

**Shtrati-nyja e vrerit**

**Zona e mëlçisë**

**Nyjet interkostale**

**Lukthi-YU**

**Nyjet lumbale**

**Nyja e apendiksit**

**Nyjet ovariale dhe gjenitale**

**Nyja e ijeve (kërdhokullit)**

**Abb. 21 Vizatimi i shemës së shpinës**
**(Shih faqen 83 të librit!)**
**Këtu do t' I risjell praktikisht gadi të gjitha të dhënat që kam përshkruar në librin tim “Libër mësimi I trajtimit të përthithjes së kikave”. Me kë¨te rast do të duhej të nënvizohet, se sa larg mund të shkohet me aplikimin e kësaj terapie. Me qëllim që disa prej vendeve të përthithjes të mund të lokalizohen më mirë, pranë secilës listë indikative janë vizatuar pjesë nga shema e paraqitur më lart.**

## 3.5.1 Zona e zverkut – Zona okcipitale

**E pagëzuar edhe si zonë e organeve Paralele**

**(Në këtë vend, hapësirë në libër pason një pamje e shpinës!-SR)**

*Lokalizimi*
**Në regjionin C 374, 2 QF**
**Paravertebral në rrjedhë me blazën e urinës dhe meridianin e vrerit**

*Drejtimet e shpimit*
**Paralelja e meridianeve**

*Drejtimi i thellësisë*
**2-5 mm**

- **Domethënja**

**Kjo zonë reprezenton një stacion të ndërmjemë të sistemeve të ndryshme rregullative, i cili ka ndërlidhje me kokën. Janë këto siteme rregullative të shkëlqyeshme të vrerit, veshkëve, nxemësit të trefishtë dhe blazës së urinës. Prandaj, nëse paraqiten pengesa në këtë zonë, do të duhej që të kërkoheshi faktorët pengues në kë¨te qark rregullativ. Zona e zverkut mund të konsiderohet edhe si zonë e organit paralel.**
**Mirëpo ne parimisht pengesat i gjejmë tek shumë persona kryesisht në regjionin e kokës dhe bëjmë gjithmonë përthithjen e përgjakur. Në pjesën përmbledhëse që pason, e përbërë nga indikacionet, nëse kjo është e nevojshme, sistemi i ashtuquajtur mbirregullativ qëndron brenda kllapave.**

- **Indikacionet**

**Neoralgjia oksipitale, subluksimet e nyjeve të unazës mbajtëse-të qarkullimit në qafë, HËS-trauma e hojbesë, hypertonia (veshkë-mëlçi), migrena e vrerit, migrena e veshkëve, migrena e lukthit të mbushur. Sinusitis maxillaris (vreri/lukthi), tonsillitis (Nxemësi i trefishtë), thrombet (mbyllësi) në regjionin karotis-basilaris, apolexie hypertonia.**
**Edhe ndaj procesit me shtrirje kaudale drejt kokës, akti i përthithjes në regjionin e zverkut ka ndikim pozitiv:**
**Syndromi i supeve dhe duarve, brahialgia nocturna (3 E/Zorrën e trashë), morbus raynaud, digitus mortus, mungesa e ndjeshmërisë së gishtit të madh ( kryeni përthithjen thellë nën Okciput) dhe gishti ulnar, tendovaginitis ulnaris, epikondylitis.**

**Atëherë kur zemra gjatë diferencimit nga ngritet nga organi C4 në shpellën e gjinjëve, mundet që tek ankesat për funksionimin e zemrës (shtypja neurale) të testohet-peket një zonë pranë HË 4 – HË6 dhe të përthithet. E njejta vlenë edhe gjatë pengesave të ndikimit mediastinal.**

**Shembull pozitiv**

1. **Trauma e hobeve para 3 vjetësh me neuralgji okcipitale të theksuar. Një herë përthithje e që të dy anëve. Përmirësim i ndjeshëm deri në shërim.**
2. **Parestezi dhe veshje e pëlqyerit (gishtit të madhë) qe pothuajse gjysmë viti. Tri përthithje të njëpasnjëshme, fare afër atllasit dhe aksisit në distancë prej rreth 1 jave. Përmirësim i shpejtë deri në shërim.**

**Shembulli negativ**

**Marramendje dhe dhimbje parasëgjithash nga një bllokadë e regjionit të HË ¾. Përthithje e dy "nyjeveve" paravertebrale. Marramendje e përforcuar, ndjesi se ke tru të thatë, extrasystoli funksionale për rreth 14 ditë.**

## 3.5.2 Trekëndshi i supeve

*Lokalizimi*

**Në C4, nyjet në muskulus supraspinalis, respektivisht në pjesën e trapeziusit e shtrirë aty pranë dhe enëve të saj ndërlidhëse**

**Në libër shih vizatimin-pamjen përkatëse!-SR)**

*Drejtimi i shpimit*

**Paralel me peridianin e nxemësit të trefishtë**

*Thellësia e shpimit*
**5-8 mm**

- **Rëndësia**

**Zona reprezenton me segmentin e theksuar më parë C4, pothuajse segmentin më të rëndësishëm dhe më të ndjeshëm. Segmenti C4 në kuptimësinë dhe rëndësinë e tij, mund ta trajtojmë edhe si “Zonë reflektive e medulla obllongata-s”. Terapeutët e shpinës me përvojë dhe masazhistët, këtë zonë e trajtojnë në planë krahasues në rast se ju duhet të trajtojnë farë zone reflektive në afërsi të saj. Ne gjejmë në kë¨te zonë nyje që kanë dhimbje të ndryshme. Brenda segmentacionit me segmental të gjatë të rregullativës së spastrimit të trupit na paraqitet një zonë e rrymuar, me që për sistemin e zorrës së trashë (pika 15), sistemin e nxemjes së trefishtë (pika 15), vreri (pika 21) dhe blaza. Trekëndëshi i supeve ka kështu nevojë të trajtohet shpesh.**

- **Indikacionet**

**Prej këndej të gjitha vatrat e sëmundjeve ndikojnë edhe në kokë, e veçanërisht tonsiliet dhe hapësira e grykës dhe gojës (Zona e grykës). Meqenëse vatrat e kokës janë të prdisponuara të preken nga sëmundje të ndryshme, atëherë është menduar se mund të ketë ndikim edhe farë sëmundje e Ikurës së zemrës gjatë vuajtjes së tonsilitisit kronik – nëse ushtrojmë përthithjen e trekëndshit të supeve si zonë e drejtpërdrejtë reflektive ndaj vatrës së sëmundjes. Pas përthithjes do të duhej të trajtoheshin nyjet e bllokuara të shtyllës kurrizore –pjesa e epërme, ajo e mesme dhe e poshtme e unazave të qafës, përmes veprimit aplikativ – nga kiropraktiku.**
**Pastaj pason përthithja këtu tek neuralgjia okcipitale, ajo e kundër marramendjes, në rast se ajo shkaktohet nga pengesat e shfaqura në unazat e qafës ose në regjionin e unazave të gjoksit (shih Unazat e regjionit të qafës së muskulus trapeziusit dhe musculus rhomboideus-it), tinitus-it.**

**Syndromi i supeve dhe i duarve, brahialgia nocturna, parestezia e gishtave, morbusi raynaud, digitus-i miortus, tendinitidet dhe tendovaginidet në regjionin e krahëve dhe gishtërinjëve dhe gjithashtu edhe i ashtuquajturi zudek-u i krahëve dhe duarve të gjitha përmes përthithjes në trekëndëshin e supeve ndikohen kënaqëshëm ose largohen krejtësisht.**

**Në varshmëri me masat lokale në vendin e penguar, përthithja ndikon në trekëndëshin e supeve edhe jashtë mbi epikondylitisin, mbi dhimbjet dhe pjesët e ajtura në nyjet e klavilkularit dhe në pjesët e ajtuara dhe dhimbjeve në regjionin e brinjëve në sternum (syndromi-tiece). Ajo ka ndikim në qarkullimin e gjakut tek glundula thyreoidea dhe mbi hemorheologi në mediastenium (Ndikim- kaps).**

**Në ndërlidhje me masat e nxemjes së lëkurës përmes hapësirave interkostale përthithja mundet që të mënjanoi angina pestorisin falsa-n.**
**Trekëndshi i supeve pothuajse në më se 90% të rasteve të sëmundjesve i nënshtrohet përthithjes së përgjakur. Përthithja pa gjak në këtë vend ose masazhat e kokave të kikave (vendeve të ngritura) shërbenmë shumë si fazë parapërgaditore për një ndërhyrje përmes përthithjes së përgjakur. Në rastet e ngarkesave depresive mundet që zona të trajtohet edhe përmes masazhës dhe përthithjes së kikave.**

**Trekëndshi i supeve të pjesës së majtë do të duhej që me një kujdesë të rëndësishëm t'i nënshtrohen trajtimit përmes përthithjes së gjakosur. Këtu shkon e ngulitet e grumbulluar si në farë depoje zona e zemrës dhe egziston rreziku që, tek personat labil ose tek ata me zemër të sëmurë, të vije deri tek kolapsi. Te një kolaps i këtillë, në raste të veçanta, mund të shfaqen një ditë pengesat e rregullativës së shtypjes së gjakut ortostatike.**

**Shembulli pozitiv**

1. **Tri vite që kur është shfaqur brahialgia nocturna me lakore tenisi. I trajtuar në rrugë klinike – ortopedike.**

**Përthithja në trekëndshin e supev, gjilpërat e vendosura për kohë të gjatë në vendin e sëmurë. Pas një jave plotësisht i sheruar dhe nuk ka farë ankesash edhe pse vazhdon të luaj tenis.**

2. **Katër javë trajtim terapeutik i tensilitisit me extrasystoli megjithë ndërprerjen e antibiotikut. Pas përthithjes menjëherë shërimi i tonsilieve dhe atë brenda një jave. Ndërkaq qetësimi i të rrahurave të zemrës pason që në ditën e parë.**

**Shembulli negativ**

**Syndromi i supeve dhe i krahut, migrena, depresioni ovarial, tip i stërmbushur. Pas përthithjes së dyfishtë pason migrena e ashpër me dëmtim të qarkullimit të gjakut, orë të tëra vjellje. Përmirësim fare i ngadalshëm.**

**Në këtë rast është trajtuar një sëmundje në stadiumin Yin përmes përthithjes së madhe (Gjendje e zbrazët) përmes përthithjes së gjakosur.**

## 3.5.3 Zona e vrerit dhe gunga e mëlçisë

| | |
|---|---|
| | **Sistemi rregullativ i vrerit** |
| **Zona e vrerit** | |
| | *Lokalizimi* |
| **Gunga e mëlçisë** | **C 7 deri TH 8 në anën e djathtë** |
| **(Shih fototografinë në libër, faqe 90!)** | **Vreri është i përqëndruar në lartësinë e pikës së akupunkturës blaza 39, të shumtën fare pak mbi dhe nën** |

**fundin medial të spina scapulae-s. Gunga e mëlçisë mbyllet në rrugë kaudale dhe mundet të zgjerohet mbi brinjë nga pjesa e prapme dhe laterale. Nga pjesa e brendshme dhe ajo e jashtme e meridianve të blazës së urinës, përfshihen në terësinë e saj një ose më shumë nyje që shkaktojnë shtypje, presion.**

*Drejtimi i shpimit*
**Rrjedha e meridianit të blazës**

*Thellësia e shpimit*
**8 mm.**

- **Domethënja**

**Përthithja në kë¨te pikë rregullon hemorhelogjinë në zonë dhe në regjionin e përqëndruar. Ajo përcakton tonusin e rrugëve të vrerit. Përmes kësaj mund ta përshpejtojë rrjedhën (largimin) e vrerit nga mëlçia. Veprimtaria e çhelmimit të organit në luftë me helmin del fitimtare.**

- **Indikacionet**

**Dyzkinezia e rrugës së vrerit, shtypja e mëlçisë nga vreri. Syndromi i post-kolecystomisë: Përthithja për trajtimin e këtij syndromi sjell përgjithësisht suksese të mira. Nuk ka tjetër metodë që do të kishte sukses të ngjashëm. Natyrisht gjatë përthithjes në raste të këtilla ngritet natyrshëm veprimi përthithës, nëse në të njejtën seancë duhet bërë edhe veprimin tjetër – ingjeksionimin me impletol të vendeve nën blanat e lekurës ose nëse duhet ngjitur farë fashe ("Pflasteri") mbi brinjët përkatëse.**
**Të gjitha llojet e hepatopathisë të shumtën me ankesa të karakterit subjektiv. Autointoksikimi tek obstipimi, gjendje shkaksore tek hepatiti etj. Parestezia në regjionin e vrerit në mëlçi me krurje dhe ndjeshmëri ngacmuese. Pengesa në regjionin e lukthit si shtypje e lukthit, mungesë lëngjesh ose hyperaciditet.**
**Me që mëlçia dhe vreri dëshmojnë ndërlidhshmëri me segmentimin mbi sy, veshë, tonsilie, ije, organet seksuale, gju dhe mbi hyrjen stimulative të qarkullimit të gjakut deri tek hemorroidet , gjatë sëmundjes do të duhej që edhe regjionin e vrerit t' ia nënshtrojmë aktit të përthithjes. Kjo është e vlefshme posaqërisht në rastin e glaukomës, të astenopisë, sinusitisit**

**koronik gjithashtu , ngajshëm si edhe tek të gjitha pengesat tjera që i përkasin sferës seksuale, si bie fjala periodat me çrregullime, mastodynia prremenstuale, libido-ja e shtuar.**
**Ulkus cruris-i në këmbën e majtë janë të varura çuditrisht shumë nga qarkullimi i gjakut në mëlçi, respektivisht nga qarkullimi i gjakut në portën hyrëse. Edhe për kë¨te duhet pas gjithashtu kujdesin e duhur.**
**Nyjet e vrerit mund të shkaktojnë edhe dhimbjet e qendrës së shpinës , sidomos të të ashtuquajturës pika e angelit me amartritidet e ashpra.**
**Gratë venerojnë shpesh një llojë tërheqje të fundit të barkut, dhimbje dhe njëfarë lloji gëlimi (si prej buburrecash-SR.) në këtë regjion si dhe paraqitjen e saj në eshtra. Këto shenja pas përthithjes në zonën përkatëse, por edhe në pjesën e majtë të zonës së vrerit, zhduken fare. Shumë grave kështu mund t' ju hiqet edhe frika nga kanceri. Në të shumtën e këtyre rasteve të grumbulluara (deponuara), si shkaktar të paraqitjeve të këytre ndeshtrashave (shqetësimeve) speciale njëfarë bllokimi të qarkullimit të gjakut në një pjesë ("unazë") të gjirit të mesëm.**
**Përthithja e zonës së vrerit është akti më i rëndësishëm në të¨re procesin e luftimit të migrenës të të ashtuquakturës biliere.**
**Përherë nyjet e vrerit gjinden në segmentin e njejtë ose në atë përballë të C ¾ . Kombinimi im personal i terapisë përqëndrohet në përthithje dhe akupunkturë. Trajtimi, respektivisht koha e trajtimit është në të shumtën e rasteve e shkurtër dhe pasojat janë jashtëzakonisht të mira. Në rastet e migrenës do të duhej që përthithja e zonës të bëhet në pacientin që është në pozicionin eshtrirë. Në këto raste do të duhej të kihet parasyshë indikacioni i mirëfilltë. Një fjalë e urtë thot: "Më ka kaluar një morr mbi mëlçI". Çrregullimi i natyrës psiçike është i ndërlidhur ngusht me pengesat në sistemin kybernetik të vrerit-mëlçive.**
**Depresioni gjatë klimaksit, depresionet gjatë përgjakjes së plotë (Plethora dhe Polyzythemia vera) munden gjatë përthithjes së zonës së vrerit të zhduken përgjithmonë. Trajtimi do të duhej të bëhej më me kënaqësi në varshmëri dhe ndërlidhje me paçe hypertonike (shih më vonë). Pacientët në të shumtën e rasteve shprehen fill pas trajtimit: "Më është hequr një barrë e rëndë".**

**Përthithja pa gjak në këto zona pason në të shumtën e rasteve në cilësinë e masazhës përthithëse të kikave në regjionin e meridianin mshikzave të urinës. Ne jemi dëshmitarë të ndikimit të plotë të kësaj metode shërimi në procesin e qarkullimit të gajkut në mëlçi  tek të gjitha rastet e mungesave të energjisë.**

### 3.5.4 Sistemi rregullativ i zemrës dhe stomakut

**(Këtu vije një pamje e shpinës – figurë! )**

**Zona e zemrës – zona e stomakut**

**Lokalizimi**
**C4/C5 deri TH5**

**Drejtimi i shpimit**
**Paralel me meridianin e mëshikëzës së urinës**

**Thellësia e shpimit**
**5-8 mm**

- **Rëndësia**

**a) Zona e stomakut: Tek stomaku atonik ose tek stomaku spastik herë-herë gjejmë në këtë segment trajtesa të forta e të izoluara. Tek gastritisi dhe hypersekretimi gjenden në trajtë kongruence në zonën e vrerit. Ato megjithatë qëndrojnë në gjendje të fjetur dhe atonike.**
**b) Zemra: Sëmundjet funksionale, koronare (Spastika e koronareve) si dhe skleroza koronare spastika e deponuar gjenë shprehjen e saj në një trajtesë nyjore në zonat reflektive të përshkruara. Ne e gjejmë atë parasëgjithash tek pletorikerni.**
**c) Zonat irritive përmes shtyrjes së statikës brenda përbrenda unaqzave të gjoksit. Agina pectoris falsa.**
**d) Sistemi rregullativ  Migrena-stomaku, i ndërlidhur me pankreasin, i ndërlidhur me paradontozën.**

- **Indikacionet**

**Indikacionet më kryesore janë dhibjet e gabuara (flase) të zemrës. Ato kalojnë pa ndryshime dhe pa u hetuar edhe nga EKG-ja. Rrallë, fare rrallë shenjohen në rubrikën e dystonisë vegjetative. Fjala është për ngarkesat neoralgjike interkostale, të cilat tek i ashtuquajturi fuci që gjindet njëkohësisht në regjionin e qafës dhe gjatë ndrrimit të motit mund të shfaqet me indikacionet e tij të mirëfillta tëspazmës koronare dhe systolisë ekstra. Kjo përvojë ka mundësi të shpjegohet përmes teorisë mbi vatrën e sëmundjes sipas Hunekes dhe Pishingerit, në anën tjetër përmes segmenteve të tërthortë të reflekseve cuti-viscerale. Jo rrollë mungojnë edhe të dhënat nga ana e pacientit: "Unë nuk mundem më të marr frymë si duhet". Dhimbjet, respektivisht ankesat shfaqen edhe gjatë natës dhe në qaste të dominimit të qetësisë. Shumë nga këta pacientë që kanë shqetësime, respektivisht që janë të prekur nga sëmundjet e zemrës, janë të rinjë, shumë të rinjë që të kenë farë dëmtimesh të mirëfillta të zemrës. Këto shenja munden të gjinden edhe tek personat që kanë ankesa të mirëfillta dhe që përmes përthithjes kanë mundësi që t' i tejkalojnë ankesat e mundëshme tashmë të grumbulluara. Masat më të shpeshta që aplikohen në raste të këtilla janë ato që kanë të bëjnë me terapitë e përqëndruara pas përthithjes.**

**Indikacion shtesë paraqet kruarja e padurueshme në pjesën e përshkruar tashmë të shpinës. Shkaqet klinike nuk gjinden dot, por gjatë prekjeve dhe hulumtimit të detajuar venerohen nyje në shpinë. Një terapi me ndikimin e duhur përpos përthithjes unë nuk e njoh. Përthithja do të duhej të përsëritej çdo tre muaj. Unë shoh arsyet për këtë gjendje në një parestezi abnormale në regjionin interkostal. Si masë shoqëruese, përpos përthithjes do të mund të shihej edhe aplikimi i ngjitësit cantarid ashtu që ai të ngjitet mbi segmentin e përthithur të unazës. Bashk me perthithjen mund të aplikohet edhe akupunktuarë me kohëzgjatje dhe me gjilpëra të ngulitura në nyjet e zbrazta. Dhimbjet në supin e majtë, në omartritis dhe ato në muskujt e shpinës janë të mundshme me veprime të thjeshta të lokalizohen dhe gjatë**

**nyjtimit përmes përthithjes mund të ndikohen kënaqëshëm. Përthithja e thatë e zonës së lukthit ndikon pozitivisht në gjumë, në tonusloze dhe mbajtjen e ajërit në lukth. Edhe e ashtuquajtura migrenë e stomakut mundet të ndikohet pozitivisht përmes përthithjes së thatë dhe përmes masazhës përthithëse të majave në segmentin e stomakut (Trajtimi në interval).**

### *3.5.5* Gunga depresive

*Lokalizimi*

**(Këtu, në këtë pjesë është skica-pamje e shpinës – shih f.95)**

**Ai përfshinë segmentin C4 e më lartë deri tek segmenti TH5. Supet duken të forta si drrasë, shpina në tërësi e shtanguar. Pacienti shpesh nga dhimbjet as që mund të flejë. Anamneza kërkon veprime të papërpunuara, që pacienti ditë e natë veq i përjeton. Ne flasim per këto raste edhe për të shtuquajturin fenomen te "Supeve ujëbartëse".**
**Përthithja në këtë regjion të shtanguar mbetet pa sukses. Dështimet janë të shpeshta. Masazha përmes përthithjes së kikave ose përthithja e thatë mund të provohet. Një terapi e nxehtë sjell shlodhje dhe lehtësim të madh.**

### 3.5.6 Dera e erës

**Sistemi rregullativ i mushkërive**

**(Shih pamjen e Shpinës në f. 96 Të librit!)**

**Lokalizimi**
**Në mes të tërthores së 2-të dhe asaj të 3-të (3 dhe 4) të unazës së gjoksit në pjesën e brendshme të Meridianit të blazës.**

**Drejtimi i shpimit**
**Në rrjedhë të meridianit të blazës.**

**Thellësia e shpimit**

**8 mm**

- **Domethënja**

**a) Lirimi i hemorheollogisë në qarkullimin e vogël të gjakut, lirimi i pjesës së djathtë të zemrës. Ndikimi prej dhimbjeve, që ngjiten përmes meridianit të blazës në kokë.**
**b) Ndikimi i dhimbjeve interkostale në regjionin e segmentit torakal 3/4/5, ndjesi shtypjeje.**
**c) Ndalimi në mediastinum do të mënjanohet.**

- **Indikacionet**

**Astma brohiale, astma kardiale. Me këtë rast do të duhej të kishim kujdesë të veçantë ndaj indikacioneve të sakta. Përthithja në këto zona në të shumtën e rastev kombinohet me përthithjen në zonën e veshkëve. Në rastin e astmës do të ishte ndihmë e mirë për të gjithë pletorikët dhënja e si një intravenoz e një spazmolytikut. Kë¨te mund ta japim edhe si terapi të përzgjedhjes së mesme dhe atë çdo 4-8 javë pa shikuar mundësinë e vazhdimit të saj. Edhe sëmundjet e mushkrive të shkaktuara nga infektimet e ndryshme reagojnë ndaj përthithjes në zonën e portës së erës. Bahmani dhe Hufelandi (Bachmann und Hufeland) kanë përshkruar suksesin në kë¨te rast si diçka shumë me fat dhe vepronin vet në rastet e rënda të pacientëve të prekur nga zjarmia e lartë pneumoniale. Fërkimet pleuritike dhe dhimbja nga pleura në këte rast trajtohen përmes përthithjes.**

**Të prekurit nga migrena që janë njëkohësisht rezistent nga terapitë kanë shpesh bllokadë në pjesën e mesme të unazës së gjoksit. Përmes përthithjes dhe vënjes në vend përmes ngjeshjes në këtë regjion, përmes durimit, po, ka mundësi të arrihet edhe rezultati i dëshirueshëm.**

**Shembulli pozitiv**

**Një burrë 45 vjeç me polyglobuli. Për shumë vjet ka cefali të ndjeshme të shoqëruar me marramendje dhe depresion. Pacienti raportonte se, më nuk po mund të shoh me sy. Më me dëshirë, vazhdonte pacienti më tutje, do të hidhesha nga dritarja. Përmes përthithjes së gjakosur arrihet të ndikohet në zonën e zverkut, të kombinuar edhe me zonën e trekëndëshit mbi supe dhe derës së erës. Pacienti pasi është trajtuar ngritet vet në kmbë, pa besuar në atë që ndjenë dhe fillon e flet, se ai ka shumë vjet që nuk e ka ndjerë veten kaq mirë. Ky trajtim, në rastet e këtilla të sëmundjeve, do të duhej të përsëritej në çdo 4 muaj.**

**Për trajtimin paliativ në rastet e shtangimeve në qarkullimin e vogël dhe me rastin e mediastinum-it për shkak të sarkom-ës, tashmë kam raportuar në një vend tjetër.**

**Shembulli negativ**

**Një paciente 68 vjeçe shtat thatake, që vuan qe pothuajse 20 vjet nga astma, pjesërisht me emfazë të mushkrive. Ka dhimbje të ndjeshme, në formë shtypjeje, në segmentin e veshkëve dhe në atë të portës së erës. Aty është trajtuar përmes përthithjes së gjakosur. Pa efekt ndaj sëmundjes së astmës, por dobësim i ndjeshëm i gjendjes së përgjithshmeme dhimbje koke për ditë të tëra.**

## 3.5.7 Zona e pankreasit (Zona e alergjisë)

| | |
|---|---|
| | **Lokalizimi** |
| **(Shih pamjen e në f. 98 të librit!)** | **BË5/6 ose BË6/7, një dorë e mirë si gjerësi pranë shtyllës së kurrizit në rrjedhë të meridianës së 2-të të blazës. Zona na paraqitet shpesh vetëm si „tip kalimtar“.** |

- **Domethënja**

**Zona në të shumtën e rasteve është pikënisje e neuralgjikëve interkostal të fortë ose parastezikëve atipik në shpinë, të cilët ju shkaktojnë pacientëve urinim të pakontrolluar, gëlime si prej skrraje (ndjesi të tilla), kruarje të padurueshme. Atë e gjejmë të ndërlidhur edhe me reumën e pjesëve të buta dhe dhimbjen e shpinës ose si pikënisje të një herpes coster-i.**

### 3.5.8 Zona e veshkëve (Sistemi rregullativ veshkë-blazë)

*Lokalizimi*

**Mbi veprimin e brinjës së 12-të deri gadi tek kaudali në gjerësinë e një doreje të shtrirë nga kjo pikë dhe 3 gishtrinjëve të shtrirë tërthorazi në të pozicionin paravertebral në segmentin TH9. Zona shtrihet në pjesën e brendshme të meridianit të blazës.**

**(Shih figurën në f.99 librit!)**

*Drejtimi i shpimit*

**Paralel me meridianin e blazës**

*Thellësia e shpimit*

**Më së paku 8mm, përveç tek pacientët tepër të dobët.**

*Pregaditja për përthithje*

**Pacientët e trashë e të dhjamosur  mbështillen me sinap për nja 10 minutë.**

- **Domethënja**

**Pas përthithjes së zonës së vrerit, përthithja e saj është sërish e një rëndësie të veçantë ngase shërben për spastrimin e lëngjeve të trupit nga lava, me që rrjedha e gjakut përmes veshkëve si**

**sasi rritet. Kjo d.t.th se arteriet sërish , brenda për brenda mpleksjes së glomerulës shlirohet dhe stazat në regjionin venoz mënjanohen, hiqen. Përpos kësaj, ashtu si është pasqyruar më lartë, vije deri te zbrazja e "Fokusit të zonës së veshkëve". Me që veshka është në qendër të aktivitetit për spastrim të materieve, pra edhe të oksigjenit, atëherë përthithja në zonat reflektive, do të duhej të planifikohet mirë, e të kihen parasyshë sëmundjet e ndryshme prej të cilave vuan pacienti.**

**Indikacionet**

**Dhimbjet e shpinës, dhimbjet në depon e veshkëve, dhimbje në pjesët e buta të reumatizuara. Migrena: Typusi përmbushje e veshkës ose zbrazje e blazës (sipas Ulrih Abele-s). Dhimbjet tek migrena e veshkëve paraqitet në kokë parasëgjithash gjatë natës dhe shkon e tërhiqet nga zverku e poshtë deri tek cepat e syve. Ajo forcohet gjatë qëndrimit në pozicion të shtrirë dhe mund të ndikohet në fillim përmes kafesë. Pacintët bëjnë me dije se, në mëngjes sytë ju kruhen (madje fort) madje edhe ju shkojnë lot për fëtyrë. Kjo symtomë paraqitet pavarësisht nga migrena. Me migrenën e veshkëve, por edhe pavarësisht nga ajo, janë të ndërlidhura përpos kësaj edhe me çrregullimet e sistemit rregullativ të veshkëve: djerësitja gjatë natës, madje edhe jashtë periudhës së shfaqjes së klimaksit, shpina e ftohtë, gjunjë dhe këmbë të ftohta, ndjesia se të përshkon diç e akullt nëpër gju ose nëpër asht, këmbë me djersë akull të ftohta.**

**Pacintët venerojnë se, ndjejnë shpesh shtypje të papërcaktuar në deponinë e veshkëve, që nganjëherë ju largohet me derdhje të sasisë së madhe të urinës fare të kthjelltë. Herë-herë, në intervale kohore të ndryshme, pacintët kanë përshtypje se, po ju rezervohet sasi e urinës. Vlera e dytë e shtypjes së gjakut në raste të këtilla kalon 90 mmHg dhe ngjitet e bie sipas marrjes së terapisë.**
**Përthithja në zonën e veshkëve ndihmon që të kursehet antihypertonika. Atë mund ta kombinojmë me përthithjen mbi unazën e 5 (Pika hypertonike). Suksesi ju jep disa autorëve të drejtë se, një pjesë e mirë e genuineve të hypertonikëve**

**paraqesin vetëm format e hershme të hypertonisë nefrogene dhe refuzojnë të shndrrohen në deponi në membranën bazale të kapilareve (Ëendt). Shrregullimi i mënyrës së ushqyerit dhe të pirit e mbështesin terapinë e përthithjes në një masë të madhe. Por edhe sistemet shoqëruese të disa tonive irreverzibile, siç është shtypja e kokës, gjendja preapoplektike, trokitja në kofkë ose edhe në sy, tinintus dhe astenopi do të përmirësohen ndjeshëm përmes përthithjes.**

**Secila përthithje e mjaftueshme (e bollshme) ulë hematokritin e gjakut. Ulja e hematokritit rreth vetëm 6% nxit në anën tjetër furnizimin e trurit me gjak rreth 50%. Atëherë mund të supozhet fare lehtë se, se gjendja e shtypjes së gjakut në kafkë ose edhe në sy (Glaukoma) përmes përthithjes të zonës së veshkëve në ndërlidhje me zonën e zverkut do të përmirëshet ndjeshëm.**

**Tek rastet e vrerit në veshkë, në shumë raste – parasëgjithash tek gratë – vije deri te të ajurit e këmbëve, që nuk do të mund të thoshim se kemi të bëjmë me një person me zemër të sëmurë apo vena insifuciente. Grumbullimi i ujit gjithashtu bëhet gadi judo në trup. Përthithja e zonës së veshkëve në kombinim me përthithjen e këndit sakral të iliosit (shih më poshtë) nxit derdhjen e ujit nga veshkët dhe shkakton dranimin e venave të gjakut. Në këtë rast më së miri do të ishte të shkohet me kombinimin e autouronozodes (shih listën e literaturës së dhënë në fund të librit).**
**Indikacion i rëndësisë së veçantë është eklampsia dhe gjendja pasuese. E cila është e venerueshme edhe disa muaj pas përjetimit të eklampsisë. Përthithja e zonës së veshkëve në kombinim me atë të regjionit të kanaleve të urinimit ndikon në mënyrë të përshpejtuar, pa kundërefekte negative dhe në mënyrë të ndjeshme pozitivisht.**
**Derdhja e djerësve valë-valë, që është fenomen për gratë gjatë periudhës së klimaksit, tek gratë pletorike reagojnë , është efekt që ndikohet ndjeshëm nga metoda e përthithjes. Edhe në këtë rast unë bëjë kombinimin e autoronosodes. Astmatikët pletorik reagojnë mirë në kombinimin e formave dhe vendeve të trajtimit në zonat e veshkëve dhe portës së erës.**

**Tek koksartroza, artritisi në nyjen sakrale të Ileos, por edhe tek format e ishiasit hasim trajta të formësuara në zonën e veshkëve. Ato do trajtuar në mënyrë të veçar nga ai i nyjeve dhe kyçeve. Tek sëmundja e cërmës (antritit) dhe reumatikët gjejmë përherë një mikroangiopati dhe çrregullimet pasuese të heorheologjisë. Këto luajnë në të gjitha pjesët e trupit të sëmurë. Mirëpo është më se e qartë, se këto procese shpejt mund të paraqesi rrezik, nëse paraqiten në organe të këtilla kaq të ndjeshme, si janë veshkët apo mëlçia/vreri, të cilat kanë nevojë për sasi të madhe të gjakut në qarkullim. Funksionimi i tyre pastaj çalon. Ndërtohen kështu zona reflektive. Ato dëmtohen përmes irritimit cuti-visceral, në kuptimin e një ridimensionimit të ashtuquajturave organe. Rrethi i djallit mundet, gjithashtu, përmes përthithjes të largohet menjëherë.**
**Tek astmatikët tipik ose në gjendjen e fundme të varësisë nga veshkët të farë sëmundjeje kjo zonë nuk guxohet asnjëherë t' i nënshtrohet aktit të përthithjes së përgjakur. Edhe përthithja e tharë në këso rastesh është e rrezikshme. Përdorimi i nxemjes të të gjitha formave dhe mënyrave është më e preferueshme.**

### 3.5.9 Gastritisi hyperacidik

**Në mesin e personave që vuajnë nga gastritisi, është një tip i veçantë, që kanë nevojë të hanë shpesh, ashtu që të arrijnë ta vënë nën kontroll thartirën e stomakut. Në rast se do të kursejnë ndonjërën prej shujtave të tyre, rreezikon t'i paraqitet ulkusi i thartirës. Por të ushqyerit e tepërt të frynë dhe të ntrashë.**

**Gjatë kontrollit të mirëfilltë të shpinës tek këta pacientë, ato – stomaku dhe zona e vrerit – janë mirë të paraqitura, me tërë kompleksitetin e tyre dhe dhimbjet e mundshme që shkaktohen nga vreri i stërkequr në "deponinë" e veshkëve. Për ta shpjeguar varshmërinë në mes veshkëve, stomakut dhe zorrës dymbëdhjetëgishtore, do të duhej ta dinim se, se përputhshmëria e pikave të stomakut dhe doudenumit në meridianin e akupunkturës "Blazë" qëndron në mes të "nyjes" së veshkës. Edhe masazhisti njeh zonat e dhimbjes tek pacientët me dhimbje stomaku si pika trysnie të Boashenit.**

**Me që edhe në sistemin e akupunkturës secili ndryshim i pikave të reagimit bivalent që është përcaktues, respektivisht përgjegjës për diagnostifikim (nënkupto: mirëkuptimin) dhe terapia (nënkupto: oligurinë, meteorizmin, ulkusin) dhe për persona të tillë (që kanë telashe me gastritisin) përthithja ndikon ndjeshëm, pothuajse ngjashëm me veprimine njohur të "largimit të gjakut nga pikat e akupunkturës). Kështu vije deri te rregullimi i sistemit rregullativ. Njëkohësisht bëhet edhe tërheqja e trysnisë neurale nga vet burimi i saj, prej TH12/L1 dhe atë përmes sistemit nervor të ndërlidhur me veshkët dhe pleksusin hypogastritisoid. Pasojnë pastaj proceset shëruese hemodinamike, të diskutueshme në rrafshin teorik.**

**Shembulli pozitiv**

> **Një 50 vjeçar, pletorik i trashë. Prej më se 10 vjetëve vuan nga ulçera recidive ventriculi et duodeni. Vlera ekstreme të thartirës. Frikë nga farë kure agjërimi, por edhe çrregullim të ritmit të zemrës dhe qarkullimit të gjakut për shkak të mbipeshës. Terapi për uljen e vlerave të thartinës me të gjitha llojet e njohura teraupeutike, herë –herë bllokim qelizash që e tejkalon me shumë vështërsi.**
> **Pas përthithjes së parë në zonën e veshkëve çduditërisht ditën e nesërme në mëngjes nuk kishte më dhimbjet e zakonshme nga të ashtuquajturat dhimbje nga mungesa e ushqimit (gjendja esull).**
> **Pacienti kishte mundësi të bindet që t' i nënshtrohet një kure të veçantë të të ushqyerit me grurë. Ditën e 3-të dhe atë 8-të të agjërimit sërish e kapin dhimbjet e stomakut (dita e çhelmimit), por përmes përthithjes at i ndalen brenda 15 minutave. Zona e veshkëve lirohet përmes 2-3 gotave me gjak, pastër. Pacienti, më vonë gjatë vazhdimit të dietës për veshkë, me ndihmën e fytoterapisë dhe përthithjes së herë pas herëshme ishte shëruar.**

### 3.5.10 Zona lumbage (Zona e zorrëve)

*Lokalizimi*

**Në mes zonës së veshkëve dhe zonës ovare, meridianit të brendshëm dhe të jashtëm të blazës.**

*(Shih pamjen e shpinës në faqen e 104 të librit)*

*Drejtimi i shpimit dhe thellësia Ngajshëm si tek zoan e veshkëve*

- **Domethënja**

**Pletora e legenit: Ndikimi i qarkullimit të gjakut në tërë hapësirën e barkut, shlirim në pjesën e poshtme të shpinës, gjendje dhimbjeje.**
**Përthotja në regjionin në mes brinjës së 12-të dhe pjesës së epërme të legenit shpeshë bëhet vetëm në njërën anë se sa në të dy anët. Do të duehj të bëhej rregull, që përethithjen ta bëni vetëm në anën që ka dhimbje. Edhe nëse skoliozet te regjioni lumbal me formësim dë qartë në trajtë gunge që simulojnë regjionin me vrerë, gjatë dhimbjes do të duhej që përthithja të bëhej vetëm në pjesën konvekse para legenit dhe atë më së miri në formë të tharë.**
**Edhe në zonaën lumbale përthithja do të duhej të bëhej me kujdesë të shtuar dhe në pozicionin ulur , duke mbajtur shpinën mirë të lakuar. Nëse nuk bëhet përthithja në vendin e duhur, në qendër të nyjes, efekti nuk do të jetë i shkallës së duhur. Edhe në regjionin e lumbalës përthithja do të duhej të kryhej pas masave gjegjës konkrete, pra pasi ta nxeni vendin mire përmes leckave të ncehta. Tek pacientët tepër të trashë , tek të cilën enët e gjakut mund të jenë ëdematoze ose të ngjashme si tek ata që aknë hypotyreozë në dukje të thatë, gjatë përthithjes nuk del fare gjak nga nyjet (gelozat). Gjithashtu përthithja e përgjakur e pozicioneve tepër të shtangura – nyjeve ndërlidhëse në glutojs maksimus-it ose të regjionit të legenit, nuk janë të preferueshme ngase më shumë mund të shkaktojnë dhimbje se sa lehtësojnë gjendjen si tërësi.**

- **Indikacionet më të shpeshta**

**Neoralgjitë në regjionin e nervus genitofemoralis-it, të nervus ilioinguinalis-it, të nervus ishiadicus-it, të nervus femoralis-it. Dhimbjet që barten tek zorra dhe tek mëshikëza e ujit. Meteorizmus, spazma e zorrës e shkaktuar nga gjendja nervore.**

### 3.5.11 Përthithja tek neoralgjitë interkostale

**Vendet për përthithje shtrihen kryesisht në hapësirën interkostale, të shumtën e rasteve ngusht-paravertebral, 1 deri 2 gishta në pozitën e pjerrtë pranë shtyllës kurrizore. Nyjet janë të asaj natyre që shtrihen në zonat e sistemit rregullativ dhe fare të ndryshme nga njëra – tjetra. Shpesh i gjejmë tek unazat në gjendje fare të rëndë , apo fare të bllokuara, kështu ndodhë gjatë "ngritjes së peshave", ose "shtrirjes"së pakontrolluar. Tek sëmundjet e costeve me ndezjen e rrënjëve të nervave në fillet e sëmundjes gjejmë një nyje (gelozë) fare të nxehtë në segmentin paravertebral.**
**Kjo nënkupton se, menjëherë aty, tek regjioni i dëmtuar, rspektivisht i sëmurë, paraqitet nervi i konglomeratit të organeve (sympathicus-i, parathympaticus-i, nyjet e unazave të kurrizit, ) që zotëron zonën e drejtpërdrejtë reflksive të shpinës. Në rast se në fillim të costersit bëjmë kombinimin e përthithjes së përgjakur në nyjen e nxehtë me terapi manuale (hiroterapi) dhe me diçka pocain (Impletol) në segment, sëmundja në të sumtën e rasteve kapet lehtë, mund të zbutet dhe më vonë edhe te zhduket fare. Për ngritjen, respektivisht forcimin e sistemit të imunitetit të trupit si tërësi është e preferueshme të përdoret ingjeksioni me gjakun vetanak ose i ashtuquajturi HOT.**

**Shumë më vonë paraqiten dhimbjet e costerit në rast të një kombinimi të kësaj natyre. Në raste të këtilla ndihmon më shumë kombinimi i përthithjes së gjkaosur me terapinë manuale dhe akupunkturën e ashtuquajtur** *Nogier* **(Orgeometria). Përthithja e**

**nyjeve interkostale do të duhej të bëhej përherë e shoqëruar me terapi manuale (Teknika sipas Labos-it ose Sell-it).**

**Shembulli pozitiv**

**Pacientja 30 vjeçe, mepamje të qartë, tipike të personit me deprsion dhe frymëmarrje të çrregulluar (për mëse gjashtë muaj) dhe anginë funksionale pectoris ek hypotonia.**

**Diagnoza**
**Tonsilitis kronik, procesus spondylosi me dhimbje në regjionin e BË4/5. Menjëherë pranë BË3 në të majtë të BË5 në të djathtë të nyjes së nxehtë.**

**Terapia**
**Përthithje e përgjakur në të dy anët të shoqëruar me ngjeshje. Pacientja tek tashti, pas gjashtë muajsh, merr frymë shlirshëm, pa pengesa. Pastaj pengesat në vatrën e sëmundjes të tonsillies me empletol, më pas përulje me karakter simbioze si dhe trajtim të përqëndruar të paravertebrales dhe sforcimit të imunitetit të organimit. Shërimi brena katër javëve.**

**Shembulli negativ**

**Një pacient thatak, 50 vjeçar, që vuan për shumë vite nga alergjia e theksuar në gishtin e madh dhe në pjesën e epërme të supit në kuptimin e parastezisë. Gelozat e ashpra në regjionin parasakral, në vendet ku pas shtypjes shkaktohen dhimbje pranë nyjes së segmentit 4 dhe 3. Nuk ka zona të ulta mbi procesusin spondyloz.**

**Megjithë mangësisë së nyjeve të nxehta përthithje e përgjakur. Keqësim i ndjeshëm në zonën e zgjeruar të nervus pudentus-it dhe nervus ileofemoralis-it. Ditë të tëra dhimbje të përherëshme të kryqeve. Çrregullim të hypotonisë shoqëruese.**

### 3.5.12 Këndi lumball

**Regjioni i komblikut të vogël –zona ovale**

**Lokalizimi**

**(Shih pamjen e shpinës faqe 108!)**

**Segmenti L2 deri tek ai L3 menjëherë në kënd, i cili krijohet nga os sacrum-i, nga shtylla kurrizore dhe nga slaji i Ileumit. Vendi përcaktohet saktësisht përmes nyjes (gelozës) së ulur.**

*Drejtimi i shpimit*

**Paralel me meridianin e mëshikzës së urinës.**

*Thellësia e shpimit*

**5-8 mm**

- **Domethënja**

**a)** **Sistemi rregullativ i mëshikëzës dhe vrerit të saj me një përkujdesë më të veçantë të qarkullimit të gjakut në komblikun e vogël dhe në rezultatet hormonale të organeve seksuale.**

**b)** **Dhimbjet në regjionin e lumballës, ne atë të regjionit të mëshikëzës (neuralgjitë në nervus genitofemoralis dhe nervus pudendus), neuralgjitë në nervus ishiadicus dhe nervus femoralis lateralis, si dhe në nervus peronojus.**

**c)** **Koksartrozë, gonartrozë.**

**d)** **Çrregullime në qarkullimin e gjakut në ekstremitetet e poshtme arteriale dhe venoze. Ndalim i qarkullimit të limpfës në këmbë.**

- **Indikacionet**

**Ankesat e mundëshme të çfardo natyrej, veçmas tek rastet e hypertonisë. Dysmenorrhëtë dhe Amenorrhëtë sekondare të grave pletorike. Prostatata, hemorroidet (në kombinim me zonën e vrerit). Migrena e ndëlidhur ovariale tek hypertonikët ose tipat e stërmbushur (Tipi-oketsu sipas shkollës japoneze = gjakun e papastër). Trysnia në kokë dhe djerësitja e kokës ante menses. Lumbago-ja, dhimbjet nervore, neoralgjitë e mëshikëzës, trysnia në mëshikëz, hernitë lëvizëse në mëshikëzën e ujit (në lidhje me ngjitësin Contharid ose akupunkturë dhe zgjatim). Dhimbjet e shpinës pasojnë me goditje të stilit të rrufesë, madje edhe gjatë qëndrimit në pozicionin ulur, nëse indikacioni i përthithjes është tipik. Suksesi i atypëratyshëm është i varur nga fakti se dhimbjet a janë fare<të reja, një ditëshe, apo të vjetra – tri vjetëshe. Tek lumbagoja do të duhej që pasi t'i nënshtroheni terapisë përmes përthithjes, të bartni më pas një tip shokeje (ngjitës – pflaster Contarid) dy-tri ditë. Ky indikacion do të shihet përmes reflektimit tek indet lidhore të tërthorta dhe procesit përkatës të spondyllozës. Parastezia në regjionin e pjesës së poshtme të supit dhe të gishtave të këmbëve, parasëgjithash tek syndromi Burning-yndyror ose tek Cruralgia nocturna mundet madje të përmirësojë sërish atrofinë e këmbëve.**

**Nyja e ijeve , ashtu si edhe nyja e dëmtuar e gjurit, ka zonën e përthithjes. Ajo ndodhet rreth 5 gishta në pozicionin e shtrirë-tërthorë kaudal të zonës së veshkëve. Nyja e ijeve përmes ndihmës që i ofron përthithja ka mundësi më të mira të ndikimit krahasuar me atë të gjurit. Përthithja e saj i përgjigjet në njëfarë mase pikës së përthithjes së veshkës dhe asaj të akupunkturës. Nëse dhimbjet e nyjeve të ijeve duam të trajtohen përmes metodës natyrpre aplikative, atëherë këto vende nuk duhet shpërfillur, përndryshe nuk do të kemi sukses afatgjatë të dëshirueshëm.**
**Tek disa gra zhduket deponia e ujit në arteriet ndërlidhëse mbi pjesën e brendshme të gjurit pas përthithjes së zonës së Ilioskrale. Gjithashtu edhe pjesët e anjtura limpfatike në grykën e gjurit përmes një akti të kesaj natyre (përthithjes) mund të zhduken.**

**Në ndërlidhje me përthithjen e gjakosur të zonës së vrerit ose të zonës së veshkëve përthithja e ileoskaraleve ka vlera tek: plebostaza, plebitisi, shtangimi i pjesës së poshtme të kofshës, ulcus criuris-i, këmbët e ftohta dhe tek ndjeshmëritë e mëdha që përjetohen pas prekjeve të gjunjëve mbi akull ose në pulpat e këmbës.**

**Tek pjesët e poshtme të kofshës së tepërmi të nxehta, të sforcuara, tek të cilat duken edhe blana të mavijosura, unë kombinoj përthithjen e këndit Ilioskral me veprimin japonez në pjesën e ndieshme (Teleangiektasien) të kofshës. Me kë¨te rast unë vë në shfrytëzim një gjilpër trekandëshe ose të ashtuquajturën fletushkë të hemolanit. Ankesat zhduken, edhe nëse më heret kanë qenë prezente me vite. Një seancë e tillë largon edhe dhimbjet e mëdha, në të shumtën e rasteve, për një gjysmë viti apo edhe për tërë vitin.**

**Disa pacientë e thonë se gjatë natës nuk mund të flejnë ngase përherë kanë nevojë të prekin në gjesende të ftohta pulpat e nxehta dhe tek atëherë mund të flejnë nëse këmbët i varin në shtrat. Në raste të këtilla preferohet përthithja e tipit të Ileosakralit në kombinim me akupunkturën e vrimave sakrale ose në kombinim me homeopatinë.**

### 3.5.12 Përthithja e përgjakur mbi spinën laterale ose drejtpërdrejt në të iliaca posterior superior

*Indikacionet*

**Ishiasi, Dysmenorr-i, dhimbjet e kryqeve, obstipacioni kronik, dhimbja e kokës tek tipat e ndieshëm nga ndrrimi i klimës.**

**(Shih vizatimin në faqen 111 të librit!)**

**Shembulli pozitiv**

> **Pletorike, 50 vjeçe, valë djerësitjeje me paraqitjen e migrenës, trysni të përhershme në kokë dhe çrregeullime në të rrahurat e zemrës. Marramedaj pas ngritjes në këmbë. Përthithja në vendin e përshkruar këtu. Pacientja pas përthithjes ngritet në këmbë, merr frymë e lehtësuar dhe thot: "Ka vite që nuk e kam ndjerë veten mirë sa tashti".**

## 3.5.13 Paça e hypertonisë

*Lokalizimi*

**Mbi procesus spinosus të unazës së 5-të, për aq sa aty është një nyje (gelosë) e nxehtë ose për aq sa shkarkohet energjia e përthithjes së televeprimit. Shumë rrallë përmes unazës sakrale tek e njejta diagnozë.**

**(Shih vizatimin në faqen 112 të librit!)**

*Drejtimi i shpimit*

**Paralel me meridianin e drejtues**

**Thellësia e shpimit**

**3-5 mm.**

**Përthithja në këtë vend nuk është pa rrezik. Do të duhej shmangur cfardo lëndimi të mundshëm të përzgjatjes së boshtit, respektivisht shtyllës kurrizore. Ngacmimi i përthithjes është i madh dhe reagimi i organizmit nuk është e mundur gjithherë të jetë balancues. Përthithja në këtë vend e ulë tensionin e gjakut në mënyrë të ndjeshme. Prandaj duhet të kihen parasysh rreptësisht indikacionet e këtij vendi.**

**Në kuadër të kësaj duhet të kihet parasysh që shtypja e gjakut nuk duhet të jetë më e vogël se 160 systolik. Numri i pacientëve me mbipeshë janë më të shumtë se sa ata thatanik.**

- *Domethënja*

1. **Dhimbjet në kryqe**
2. **Trysni dhe shtypje me kohëzgjatje në kokë gjatë hypertonisë, vecanërisht nëse kemi të bëjmë me depresion reaktiv  në periudhë klimaksit.**
   **Hypertonia "e kuqe" zbret në 10 deri 30 Hg, shpesh disa muaj ka mundësi që t'a reduktoni përdorimin e barërave. Ankesat e karakterit subjektiv të ndërlidhura me hypertonin e theksuar , sic është marramendja, shikimi i turbulluar, zhurmën në veshë ka mundësi të zhduken. Përthithja megjithatë nuk zëvendëson as barërat,  as dietën por as edhe ushtrimet me efekt për enët e gjakut!**

**Depresionet tipike për periudhën e klimaksit. Paca e hypertonisë në periudhën e klimaksit sidomos tek gratë dhe rrallë tek burrat vije edhe pa paralajmrimin e hypertonisë qenësore.  Shtypja përmes gishtrinjëve të dorës në këtë vend  zgjidh "ulurimën e mjerimit tipik. Në  këto vende përthithja shpesh ndikon si trajtim mrekullibërës dhe vecmas nëse përthithja në zonën e vrerit (rrallë në zonën e veshkëve) kombinohet me agjërim. Mbetjet e depresionit ka mundësi të shmangen pastaj edhe përmes ngjitësit (pflasterit)-Canthariden, të cilën e vemë mbi unazën e 5 të ijeve dhe mbi atë të parën sakrale.**

**Përmbledhur me pak fjalë do të mund të thoshim:**
*Trajtimi i paçës së hypertonisë ulë shtypjen në tru.*

### 3.5.14 Vendet e veçanta të përthithjes

- **Nyjet e ijes**

*Lokalizimi*
**Major i tohantës ose 2 gishtrinjte në pozicionin e pjerrtë kranial, respektivisht kaudal. Pacienti sillet e bie ne barkose rri në pozicionin anash, në krah.**

**(Shih figurën në faqen e 114-të të librit!)**

*Drejtimi i shpimit*
**Paralel me meridianin e vrerit**

*Thellësia e shpimit*
**Deri në 8 mm**

**Tek formësimi i shkelqyeshëm i trajtës së nyjëzuar (gelose) në regjionin e nyjes së ijeve dhe nëse kemi përshtypjen se kemi të bëjmë me formësim tipik të kuqrremtë, atëherë përthithja mund të jetë ndërhyrje e rreptë dhe me efekte shumë pozitive. Tek koxarthrotikët e thatë aplikimi i përthithjes së përgjakur zvoglon dhimbjet - është më i preferueshëm.**

**Nyja e gjurit**

**(Shih figurën në faqen e 114-të të librit!)**

**Lokalizimi**
**Në quadriceps, në të shumtën në madhësinë , respektivisht gjerësinë e një dore rrallë mbi patellë, rrallë në vijen e mesit, më shpesh laterale se sa mediale.**

*Drejtimi i shpimit*
**Meridiani tërheqës paralel**

**Thellësia e shpimit**
**5-8 mm**

**Tek formësimi i nyjeve në regjionin e nyjeve të ijeve dhe nëse kemi përshtypjen se kemi të bëjmë me të ashtuquajturën nyje (Geloze) të kuqe, përthithja do të mund të shmangëte të ashtuquajturën koksalgi. Indikacioni është, megjithatë, i rrallë. Tek personat thatak, përmes përthithjes së kikave (majave) mund të vije deri tek zbutjet e dhimbjeve.**

- **Nyja e gjurit**

**Lokalizimi**
**Në Quadriceps, në të shumtën e rasteve mbi patela, rrallë mbi**

**vijën e mesit, të shumtën laterale ose mediale.**

**(Shih figurën në faqen 115-të të librit!)**

*Drejtimi i shpimit*

**Paralel me meridianen përshkuese.**

*Thellësia e shpimit*

**5-8 mm**

**Sipas rastit gjinden edhe mygoloza të çastit dhe parasëgjithash nyje të kuqe, në të cilat sikur edhe në një blanë gjaku mund të ndalemi. Shtangimi reaktiv i muskujve e pengon qarkullimin e rrymave të gjakut nëpër shpinë prej vet nyjeve.**
**Nyjet ndodhen në të shumtën e rasteve në pjesën laterale ose mediale të quadricepsit. Ne i venerojmë paraqitjet e tyre në varshmëri me koksartrozën, shkurtimin e këmbës me skoliozën ose bllokadën e nyjes iliosakrale. Dhimbjet që shpërndahen nga ana e mykolozës shkojnë drejtë gjurit deri tek ijet ose përshkon pjesën mbi gju përpara deri tek zogu i këmbës.**

**Shembulli pozitiv**

**Një paciente 45 vjeçe ishte trajtuar nga ana e mjekut kot për disa vite me radh për shkak të dhimbjeve në regjionin e gjurit. Këto dhimbje shpërndaheshin nga një vend i ajtur (nyje) në pjesën e jashtme të quadricepsit deri tek ijet përpara dhe mbi gju poshtë. Përmes fotografimit rendgenologjik përcaktohet prania e koksatrozës në gjendje të përparuar, që në fakt pacientën fare nuk e pengonte. Mirëpo dhimbjet që barteshin nga nyja gjaë natës nuk e linin më të qetë. Trajtimi përmes përthithja disa herë radhazi, për një kohë jo edhe aq të gjatë, bëri që dhimbjet brenda disa muajve të pakohen dhe pacientja, e cila para fillimit të seancave për trajtim kishte ardhur me kërrule në ambullantë, tashti nuk kisht emë nevojë për shkop. Gjithashtu edhe dhimbjet e natës u arrit që të mënjanohen.**

**Profesori për endoprotetik, te i cili pacientja vizitohej rregullisht dhe kërkonte ndihmën e tij, ias shtroi asaj një pyetje plot habi, se përse ajo tashmë papritmas nuk ka telashe me nyjet e ijeve.**

## 3.6 Topologjia indikative për përthithjen e thatë

- **Vërejtje paraprake**

**Që ta kuptojmë mënyrën e ndikimit të përthithjes së thatë dhe masazhës së kikave, do të duhej të rilexoheshin vërejtjet në pjesa teorike të librit, pra pjesën e parë. Ngase vetëm pasi ta keni kuptuar atë mund t'i njihni qëndrimet dhe indikacionet pasuese. Përshkrimi i topologjisë pason s¨rish nga kraniali dhe vazhdon drejt kuadalit.**

### *3.6.1 Zona e zverkut*

*Regjioni C3 deri te ai C4.*

*Shih figurën në f. 117 librit!*

*Në këtë pjesë nuk do të duhej kurr ta kryejmë të ashtuquajturën të përthithje të thatë përmes çelçit përthithës, por këtu ka vend për masazhë të kikave (nyjeve). Si përjashtim nga kjo rregull vlen përthithja e thatë mbi të ngriturën e supit në regjionin C4. Në parim në këtë rast zakonisht veprohet sikur edhe gjatë masazhës me monedha, gjatë të cilit akt paraprakisht trupi lëmohet dhe nxehet mirë me vajin e ashtuquajtur japonez (piperi).*

**Masazha e kikave-nyje në regjionin e zverkut në të shumtën e rasteve është me dhimbje. Tek personat e ndishëm do të duhej që të veprohej vetëm me buzët e çelçit për përthithje, por pa tërheqje të ajrit në vendet ku trajtohen përmes kësaj metode. Shtypja me anë të çelçit ndikon në paraqitjen e ekstravazateve.**

**Përthithja e thatë mundtë jetë si kompletim i përthithjes së përgjakur, ngase shtangimet në vatrën e kutis-it mbi sup mund të shpërbëhen.**

### 3.6.2 Nyjet e supeve

(Shih figurën në f. 118-të librit!)

Sie çdo kyç edhe ky mundet që përmes aplikimit, vendosjes së gotave të çelçta për përthithje në të shumë prej pikave të trigerit, të ketë qarkullim më të mirë të gjakut. Efektet në nyjet e supeve janë të shkallës së mesme.

### 3.6.3 Zona e stomakut

(Shih që të dy figurat në 119-të të librit!)

Në regjionin e zonës së stomakut i vëmë disa gota çelçi për përthithje në të njejtën kohë në rrjedhë të faqen meridianit të brendshëm dhe atij të jashtëm të blazës. Gjatë rasteve në gjendje gjumi , tek pyloruspazma dhe pazma e stomakut, hypoaciditetit ose anaciditetit si dhe gjatë bartjes së motiliditetit, kur ke ndjesi se ke gurë në stomak ose tërë globin në herdhe dhe mëshikëzën e urinës, rezultati është i mirë ose relativisht i mirë. Efekte pothuajse të papritura do të mund të arriheshin, nëse trajtohet në të njejtën seancë, duke u ndrruar, fillimisht zoan e stomakut dhe pastaj ajo e barkut (pjesa e poshtme). Aty do të duhej vënë gotat e thata të çelçit dhe atë mbi pikat e alarmit të stomakut, të zorrës së trashë 3E, pjesërisht edhe mbi pikën alarmuese të vrerit në majen e brinjës së 11-të.

### 3.6.4 Pjesa e përparme e thoraksit

(Shih figurat në faqen 120 të librit!)

Kikat e përthithjes vihen të thata mbi pikat e akupunkturës: mushkria 1 dhe 2, veshka 13, si dhe atë të parasternalit deri tek ai i ksifoidit.

**Indikacionet**

**Efekt pozitiv tek bronhiti i kronik akut i trakieve.**

### 3.6.5 Regjioni i gjinjëve

**(Shih figurën e dytë në faqen 120 të librit!)**

**Sipas Bahmanit trajtimi përmes përthithjes së thatë i pjesës së poshtme të Zirkumferencës së gjinjëve dëshmon suksese të mira në këto raste: tek tensionini i lartë hormonal i shoqëruar me anemi.**
**Hypermenora rezulton jo rrallë nga humbja e tonusit të uterusit. Kafshimi i foshnjes gjatë të thithurit vlente për gjinokologët e vjetër si metoda më e mirë që të nxitet mitra pas sterilizimit (lidhjes së grykës së mitrës) për kontrakcion.**
**Në ditën e parë të peiodave (përgjakjes) i vini dy gota të çelçta për përthithje në kikat përkatëse. Rezultate pothuajse të njejta do të arrini edhe nëse bëni nxitjen e qarkullimit të gjakut për shkak të mungesave në fazën e ashtuquajtur Corpus-luteum ose pas periudhave.**

### 3.6.6 Pjesa e poshtme dhe ajo e mesme e shpinës

**(Shih figurën në f. 121-të librit!)**

**Këtu kemi të bëjmë me segmentet C4 dhe Th9. Trajtimi bëhet në të shumtën e rasteve përgjatë pjesës së brendshme dhe asaj të jashtme të meridianit të balzës. Trajtimi statik I kikave përmes aktit të përthithjes ashtu si edhe trajtimi dinamik përmes masazhës me anën e gotave përthithëse nfikojnë pothuajse në rrugë e mënyrë të njejtë.**

**Masazha përmes gotave nuk do të duhej të shkaktonte dhimbje (efekti sedues me humbje të energjisë).**

- **Indikacionet**

a) **Hypotonia, veçmas pas infektimit. Në këtë rast edhe unaza C7 pëson hypernim.**
b) **Neuralgji tek personat reumatik dhe me nyje të ftohta në tërë regjionin e shpinës.**
c) **Gjendje neuralgjike gjatë ose pas tharjes së pleuritideve.**
d) **Trajtimi paraprak në rast të terapisë manuale, në rast se nuk kemi të bëjmë me nyje të nxehta. Shpina përmes masazhës përthithëse në tërësi çlirohet. Shtangimet patologjike në segment humbin si në thellesi ashtu edhe në kutis. Në të njejtën mënyrë, në mos më shumë, ndikon në këtë rast edhe masazha e ashtuquajtur e monedhës.**

### 3.6.7 Pjesa e kryqeve të këmbëve

**(Shih figurën e sipërme në faqen 122 të librit!)**

**Përthithja e thatë këtu ndikon pozitivisht dhe atë në këto raste: tek florura e vajzave të reja, amenorrhëja sekondare, dysmenorrrhëja, dhimbjet e kryqeve tek pagjaksitë e përgjithëshme.**

**Gjatë aplikimit tëkësaj metode (përthithjes së thatë) në këtë zonë kihet kujdesë i veçantë që të mos bëhet asesi përthithja e të ashtuquajturave zona të stërmbushura ose atyre të zbrazta. Masazha përmes gotave të çelçta në këtë regjion (kryqet e këmbëve) mund të përsëriten për çdo ditë. Në rast se na paraqiten trajta të mëdha të hematomeve, atëherë duhet pritur derisa të kryhet procesi i përthithjes së tyre (resorpcioni).**

### 3.6.8 Pjesa e poshtme e barkut, ija, pjesa e brendshme e kofshës së epërme

*Indikacionet*

**(Shih figurën e poshtme në f.122 të librit!)**

**a) Amenorra sekundare, hypermenorra dysmenorra.**
*Domethënja:* **Qarkullimi i gjakut në komblikun e vogël rregullohet.**

*b) Gjendje me dhimbje pas Adnexitisit/parapetritis-it.*

*(Shih figurën në f.123 të librit !)*

*Përmirësim i aftësive përthithëse (resorptive) pas operacioneve gjinekologjike dhe pas ndezjeve në komblikun e vogël.*

*c) Paraliza e mëshikzës së ujit dhe insuficienca e hapjes së ureterit.*

*Lidhur me këto indikacione në një rast unë pata cituar rezultatet e veneruar të Bahmanit më 1951 tek një pacient i tij :*

> *« Një burrë 35 vjeçar ishte lënduar diku në një fushëtirë të Rusisë dhe gjatë transportit, për shkak të të ftohtit të madhë, i ishte paraqitur Cystiis/Pyelitis-i, që i kishte shkaktuar vuajtje për më se një vit në regjionin e mëshikzës, që kishte rezultuar me inkontinuentinë e plotë të urinës. Pra se të vije pacienti tek unë kishte qëndruar rreth 3 ½ vjet në spitale dhe lazarete i shtrirë në shtrat dhe iu kishte nënshtruar një varg terapishë. Ai megjithë trajtimin e gjatë dhe përdorimin e sa e sa medikamenteve të njohura deri atëherë, ishte lëshuar në shtëpi pa rezultate në shëndetin e tij.*
> *Unë fillova trajtimin e tij duke i bërë banjo me ujin (çajin) e barishteve ulur poshtu në barë, duke i bërë përthithjen e tharë të kikave në zonat reflektive të blazës (suprapubike) dhe uritresë së djathtë për së gjati dhe asaj të majtës përgjatë shtyllës kurrizore. Përveç kësaj, çdo të 8 ditë i jipja edhe nga një autouronozodë.*
>
> *Përmes trajtimit arrita që në një kohë të përshtatshme klimatike (në vjeshtë dhe dimër) të kem sukses të plotë – pacienti të sherohet plotësisht. Riciklimin e lehtë të rastit pas një viti, përmes trajtimit në mënyrë plotësisht të njejtë*

> *për 4 javë rresht, arrita ta përmbyllë me sukses të plotë, ashtu që pacienti kishte mundësi sërish t'i kthehet profesionit të tij si depoist dhe të punojë si më parë ».*

**Nëpjesën e brendshme të kofshës së epërme kikat e përthithura do të vihen përgjatë musculus gracilis-it.**

## 3.6.9 Proceset reumatike, pengesat e qarkullimit të gjakut, Ulcera

**Me përvojën e tij të shkëlqyeshme pjesërisht edhe përmes përthithjes së thatë të modifikuar, na jep Sigfris fon Nizen (Siegfried von Niessen) dhe atë tek të gjitha proceset reumatike dhe tek pengesat në qarkullimin e gjakut si dhe tek lunga tropike të ekstremiteteve.**
**Në këtë rast ai ka përdorur pjesërisht teknikën e shtypjes së dhomzave, në të cilën ai përmbyllë një ekstremitet të tërë dhe pastaj lëvizë në gjurmët e Prof. August Biers-it, i cili që në vitet e njëzeta (të shekullit të XX-të –SR), përmes teknikës së emërtuar nga vet ai si «Lidhje ndalese » -( Staubinde) ka pasur rezultate interesante tek indikacionet e dhëna më lartë.**

## Pasthënje

**Në kuadër të klientelës së shenjtë (personave që kërkojnë shërim në mjekësinë alternative) ka kohë që po bëhet një përmbysje e plotë konceptuale. Në njërën anë po rritet numri i mjekëve, të cilët sërish po i kthehen metodave të vjetra të trajtimit të pacintëve mbështetur në përvojën e gjatë të mjekësisë popullore, në anën tjetër ata sulmohen ashpër nga përfaqësuesit e habilituar të cilët mbështetën në shkollën e mjekësisë.**
**Për faktin se që të dy grupimet kanë lëvizuar megjithatë nga pozicionet e barrikaduara më parë, i detyrohemi parasëgjithash « trysnisë që është bërë nga poshtë » : një pjesë e mirë e popullsisë po refuzon në mënyrë të ndjeshme mjeksinë shkollore dhe metodat dhe rrugët që ndjek ajo për trajtimin e të sëmurëve dhe po i kthehet mjekësisë aplikative, natyrore.**

**Por se sa afër qëndrojnë kokat e që të dy këtyre sistemeve shëruese, do të mund të shihej nga dëshmitë pasuese të që të dy palëve në fjalë. E para i përket Profesor H.Momsens-it, një mjeku për fëmijë tashmë i mplakur. Në zanafillën e punës mjek I arsimuar, ashtu si çdo mjek në fillet e karrierës së tij, gjatë ushtrimit të profesionit të tij me klientët e tij të vegjël, ia ka kushtuar një pjesë të kohës thellimit të hulumtimit shkencor, që do të mund ta emronim si "Njeriu dhe symbionta e tij". Si rezultat I hulumtimit të përkushtuar dhe eksperimenteve të tij të shumta, ai ia kishte arritur që të dëshmojë pa hezitime se, sa ndikim ka përqëndrimi I symbiozës së orjentuar me bekimin , respektivisht gërshetimin e saj me të ushqyerit përkatës,me bazë të shëndoshë natyrore, në shërimin e fëmijës. Ai shkruan për nocionin "Shëndet" si vijon:**

> **"Hulumtuesi analitik i fushës së shkencave natyrore, nuk gjykon përtej asaj se çfarë i rezulton analiza e tij, ngase për te është e vetkuptueshme se, shëndeti fshihet në strukturën materiale, të cilën ai ka mundësi ta hulumtoj përmes metodave të pranueshme. Nocioni shëndet, i cili është themeluar dhe ka çarë përpara përmes analizave të shkencave natyrore, shpije drejt asaj që sëmundjet të**

**njihen nga symtomet qe shfaqin, të cilat objektivisht verifikohen përmes kontrollit (hulumtimit) dhe atë mbështetur në metoda të ndryshme. Mënjanimi i symtomeve tek ky qark logjik i të menduarit nënkuptohet se ia kemi arritur të kthejmë shëndetin e pacientit në gjendje normale, të mëparshme, pra pacienti është shëruar. Ndërhyrjet kirurgjike, medikamentet alopatike, furnizimi me hormone, vaksina dhe gjëra tjera janë instrumente për shërim. Me "shërim të mirëfilltë" këto masa marr së toku, nuk kanë të bejnë fare! Ky është gjykim i gabuar me bazë logjikën e të menduarit poashtu të gabuar!**
**Kështu shpëtojmë jetën por edhe jetën e sëmundjes e bëjmë më të gjatë!**

**Grindja e njëanshme mbi këtë bazë të "Emergjencës mjekësore" shërimi aplikativ nuk sjell farë bekimi të mundshëm. Përkundrazi qoroditje dhe ngritje të shpenzimeve dhe ngritje të numrit të sëmundjeve kronike, paksim të ndjeshme të oksigjenit, duke filluar me fëmijë që preken nga kariasi i dhëmbëve dhe më tutje me reumë dhe kancer, kundër të të cilave mendimi i këtillë është fare i pafuqishëm dhe përpos kësaj ka pikëpamje të gabuara, duke mohuar se përmes njohjes më të hershme me symtomat e sëmundjes mund të rikthejë impulset e shëndetit të rrezikuar."**

**Qëndrimin e dytë na e sjell Profesor J. Hornung nga Universiteti i Lirë i Berlinit. Krejt e sigurt se artikulli i tij nuk është në kurrfarë ndërlidhshmërie me kolegët e tij të vjetër që vazhdojnë të ushtrojnë nëpër ambulantat e tyre profesionin e mjekut. Mirëpo ai ka ardhur në të njejtin përfundim, ngase ati i ka fjetur në zemër një fjalë e vjetër e shkencës, e cila thot: "do të duhej më shumë të lexojmë, atëherë nuk kemi nevojë aq shumë të zbulojmë". Ndërkaq ai nënvizon:**

- **Alternativa e mjekësisë shkollore për për studentët në Berlin**

**"Studimi i mjekësisë në universitetet gjermane është shndrruar në një akt dështimi.**

**Përmbajtja e mësimit dhe e materies për mësim janë mjekësi e pastër shkollore, kjo d.t.th. se tek studentët bartet rezultatet e njohura, dija mbi mjekësinë shkollore, të cilat që prej shekullit XIX-të janë stërprovuar në enët e laboratorëve të fizikës dhe kimisë, e që janë dëshmuar me suksese të jashtëzakonshme tashmë të njohura nga metodat e hulumtimit që njohin këto dy fusha të dijes. Për pasojë përmes hulumtimeve të kësaj natyre, tashmë është krijuar një pasqyrë mekanike e organizmit të njeriut, i cili në parim po funksionoka si një veturë ose si një kompjuter. Sëmundja prandaj, sipas kësaj pikëpamjeje, na qenka paraqitje e një defekti nënjë pjesë të tij, të cilën mund ta reparojmë ashtu siç bëjmë me reparimin e defekteve të pjesëve të një veture. Pasojë e kësaj pikëpamje është konkluza se: Njeriu nuk është më përgjegjës për shëndetin e tij; sëmundja na qenka një fatkeqësi, fat i zi, dhe shi për këtë mjeku është këtu, për çka edhe paguhet, që të pezulloj defektin dhe të na kthejë sërish në jetë. Në botën e mjekësisë duket se mbizotron bindja se çdo gjë është e mundur të bëhet.**
**Si pasojë e këti zhvillimi janë operacionet e komplikuara me teknikë poashtu të komplikuar, pra zhvillimi i kësaj teknike dhe aplikimi i saj, që shërben për ndërhyrje në përmirësimin e defekteve mekanike si dhe zhvillimi i farmaceotikës, futja në përdorim i një varg barërash që kanë shpëtuar jetëra si psh. vitamina B-12, që plotëson nevojat e organizmit në rast mungese të insulinës, por njëkohësisht kjo mendësi ka sjellë edhe deri te rrudhja e krahëve për një varg “defektesh” tjera, duke mos ditur se si të ndërhyjë dhe kështu duke i hapur rrugë përdorimit të tonelatave të tëra prej antibiotikesh, që kanë dëmtuar shumë pacientët , ngase kështu pacienti nuk është sheruar dhe në vend të shërimit kanë pasuar kundërefektet që kanë pasoja të ndjeshme në shëndet.**

*Sidoqoftë egziston një universitet në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, ku aplikohen drejtime të ndryshme të nxënjes dhe metoda të të mësuarit të një fushe, ashtu që ua mundësojnë studentëve të përfitojnë duke i ballafaquar pikëpamjet e ndryshme, nganjëherë edhe të kundërta të dijes mbi akcilën*

> *fushë shkencore, ashtu që në fund vet ta ketë të mundur të përzgjedh dhe të marr atë që e gjykon si më të shëndoshë racionalisht e që do t' i ndihmonte ati të jetë nesër një mjek i mirë dhe i sukseshëm. Pikëpamja qe unë me plot bindje e përfaqësojë rri përballë tendencave të ngurta të kohës që pretendojnë çdo gjë dhe gjithëçka t' ia nënshtrojnë rendit gjoja të pranueshëm dhe të kodifikuar edhe nga shteti, ashtu si po veprohet sot në rrugë fare të zakonshme në lëmin e mjekësisë përmes ligjeve të aprovuara dhe urdhëresave. Kjo na shpije në atë drejtim që qoftë aplikimi i metodave të reja apo edhe i atyre të vjetrave të dëshmuara si të sukseshme në shërimin e një varg sëmundjesh, njeriu t'mos i aplikojë ngase, ja, nuk na qenkan në sistem."*

*Në fund do të duhej që edhe njëherë të kthehemi tek domethënja e mrekullueshme e indeve ndërlidhëse, këtyre dëshmive bazë të jetës në thellësi historike. Me të drejtë paralajmron dhe na e tërheq vëmendjen internisti Haus për mosrespektimin e indeve. Në dhjetra vitet e hulumtimeve në fushën e histologjisë ai ka dëshmuar se, secila ngarkesë e tërësisë së organizmit - qoft ky stres, helmim, rrezatim, të ushqyerit me ushqim të gabueshëm, ngarkesa fizike, nxehtësi a ftohtësi, infektim bakterial apo viral etj. Së pari shkakton reaksion në mezenhymin jospecifik dhe atë gjithkund e kudo njejtë. Ai e ndan kë¨te reaksion në tri faza.*

*Stadiumi i parë*

**Qelizat e indeve ndërlidhëse e rrisin ndrrimin e oksgjenit, magazinojnë më shumë substancë. "Herë – herë në të njejtin vend ndrrohen molekula të të njejtës natyrë dhe atë plotësisht; vetëm koha e vlerës së tyre është e ndryshme. Kjo formë fiziologjike e RJM-së (Reaksionit jospecifik të mezehymnit) është për sëmundjen irelevante."**

**Përmes përshtatjeve adekuate të shpejtësisë të sintezës dhe degradimit rregullacioni arrinë të kalojë , respektivisht të ndrrojë oksigjenin me sukses... Organizmi me gjendje të njejtë në tërësinë e tij, peshës si dhe strukturën e prekshme,**

**makroskopike, dritën dhe lektroneonoptikën, madje edhe strukturën molekulare të qelizave të tij dhe indet.”**

*Stadiumi i dytë*

**Qeliza e mezehymnit i ngritë të gjitha aktivitetet e saj. Ajo proliferon dhe merr. Qelizat hematopoetike dhe ato lymfopoetike reagojnë gjithashtu. Kjo shpie deri tek ndryshimi i numrit të qelizave  në gjak dhe në indet ndërlidhëse. Për këtë proces janë përgjegjës materiet e sistemit monokin-cytokinit. Qelizat e gjakut kalojnë në indet ndërlidhës dhe mund ta arrijnë numrin e qelizave sesilie. Kjo shpije pastaj në demolimin e strukturës normale të indeve.**

*Stadiumi i tretë*

**Qelizat e kapilareve të indeve shndrrohen në porozitet mural. Albuminat dhe uji dalin jashtë. Transporti i substratit mblidhet. Qelizat me prejardhje nga sistemi  hematopoetik dhe lymfopoetik kalojnë numrin e qelizave sesile të qe indeve ndërlidhëse. Qelizat përfundimisht të diferencuara të organeve ndërthuren në mes vete e ndajnë sipas hapësirave sistemin furnizues dhe shpenzues  dhe degjenerojnë ose vdesin fare.  Fazat e indeve ndërlidhëse e ndrrojnë vendin e tyre.**

**Haus-i mundi të dëshmojë dhe provojë se cila epitope në cilën qelizë shërben si pikë sulmuese për noksë të përcaktuar dhe se si nuk është bërë venerimi i mëhershëm i disa prej sëmundjeve, se si arteriskleroza  ose reuma  shkencërisht “ lënë të kuptohen “nga jashtë mesenhymi”.  Megjithkëtë ky sistem që prej lashtësisë është njohur dhe aplikuar nga mjekësia popullore, aplikative dhe posaqërisht nga metodat e drenazhimit, ashtu si është përthithja e kapshme dhe e palikueshme , sipas motos,  se mjeku ka për ta mjekuar, ashtu që natyra sërish ta shëroj. Trajtimi përmes përthithjes si metodë shërimi tashti përmbush një jetë relativisht të gjatë – katër deri pesëmijë vjet si metodë shërimi dhe ndikon përmes rrugëve të veta në trup dhe atë konkret përmes indeve ndërlidhës të përshkruar. Është koha që,**

**ajo, pra metoda e përthithjes, të fitoj vendin e merituar në këtë periudhë ndryshimesh.**

**Perkthimin dhe editimin e këtij libri e përgatiti dhe e autorizoi:**

# HIDAJET BYTYQI

## PARAPSIKOLOGJIA DHE MJEKËSIA ALTERNATIVE JANË NË SHËRBIMIN TUAJ

Pas hulumtimit shumë vjeçar eksperimental tek shumë pacient që vuajnë nga sëmundjet e ndryshme.
HYPNO-AKUSTIKO-TERAPIA përmes ndëgjimit të audiokasetave që kanë bekimin magjik dhe janë formuluara me sugjestione adekuate verbale, ku me ndihmën e drejtëpërdrejtë në ndërdijen e njeriut, ku edhe realisht është shkaktari kryesor latent i sëmundjes konkrete.
Kjo metodë është origjinale dhe për here të pare zbatohet nga parapsikologu terapeut, HIDAJET BYTYQI duke patur rezultate senzacionale tek shumë sëmundje që në fillim duken gati të pashërueshme për medicinën bashkëkohore.
Kjo qendër organizon kurse kualifikuese për bioenergji, hipnozë dhe magjistari.
Pas shumë vitesh të suksesshme në Cyrih të Zvicrës,Qendra Parapsikologjike tash vepron në Prizren.
Psikoterapeuti, **HIDAJET BYTYQI**, me medicinën tradicionale kineze me hipnozë, regresion hipnotik,barna popullore.
Mjekon problemet në baza psikike,sëmundjet posttraumatike, neurozat,pagjumësinë, alergjinë,halucinacionet, frikësimet e ndryshme, sterilitetin tek femrat,bashkimin dhe zgjedhjen e fatit, koncentrimin në provime, urinimin në shtrat, belbëzimin etj.
Mundemi t' ju ndihmojmë edhe pa prezencën e pacientit.

**QENDRA PARAPSIKOLOGJIKE**
**HIDAJET BYTYQI**
**Rr.Iliaz Kuka nr.24 Prizren**
**Informatat më të hollësishme përmes**
**Mob.044-134-621 dhe**
**Tel.038-633-218**